



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Dana 20.05.2025			
Nr. i Organi Org. Broj	Numri Broj	Subjekt I. Broj	Vlera Vrednost
01-1001	01-476		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e V të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **27.05.2025 (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti. Mbledhja është e hapur për publikun. Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal,
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimin nga pagesa e punonjësve të policisë së Kosovës për shërbimet që afrohen në qendrën e Mjekësisë familjare dhe institucionet e tjera shëndetësorë që menaxhohen nga komuna e Vitisë.
4. Informatë për Manifestimin Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2025".
5. Informatë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë.

Viti, më 20.05.2025

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KATËR TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.04.2025 (e martë) në shtëpinë e kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu; këshilltarët e Kuvendit, si: z.Ramadan Deliu, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Sokol Hyseni, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Sokol Shaqiri, z.Basri Sylejmani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emini, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, znj.Lindita Demelezi, znj.Majlinda Shabani, z.Durim Sylejmani, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete Rama, z.Reshat Azizi, z.Taulant Haxhiu, znj.Anisë Zejnullahu, z.Veton Ramadani, ndërsa mungoi, znj.Marigona Avdiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike dhe të tjerë. Pasi u konstatua se prezent janë 19 anëtarë të KK-së, po besoj që të tjerë vijnë ndërkohë, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katër të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Gjatë kësaj periudhe kohore janë kthyer të gjitha aktet e ligjshmërisë, që janë në rregull. Para se të hymë në rend të ditës, kemi pjesën për pyetje dhe përgjigje, fjala është për juve.

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ne e dimë që për shkollën “Halil Alidema” kemi bërë përrurimin e shkollës me 16 janar. Në atë shkollë, edhe pse është bërë përrurimi, edhe pse është shkolla e re, mësimdhënësit, drejtorja, sekretari mu kanë lajmru që kanë probleme të mëdha. Përveç dëmitmit të sanitarisë, se është shumë e dobët. Problemi tjetër është me ujë që pikë me kanalizim. Tash së fundi më thanë që ka dalë edhe një problem shumë i madhë. Ne e dimë që ajo shkollë ka edhe sallën e sporteve. Krejt ajo sallë është tu pikë dhe është nxirë parketi, ai parket që është i vendosur. Krejt salla ka pikë dhe nuk e di kush ndërmerr masa për të. Ajo punë, ne e dimë që është kryer prej nivelit qendror. Kontratën që e ka marrë është një prej Istogu, është një nënkontraktues që e ka kry prej Komunës së Vitisë. Kërkoj nga nënkryetari, nga Drejtorja e Arsimit që me marrë masa që sa më parë me ndërmarr diçka. Tjetra, prapë ka të bëjë me shkollën “Halil Alidema” dhe “Kongresi i Manastirit”. Unë kam qenë një prej tyre që kam ngritë zërin më së shumti, për me i hjek deponitë në Pozheran dhe në Komunë të Vitisë, ndërsa kjo deponi gjendet në oborrin e shkollës “Halil Alidema”, e shkaktuar nga po kjo kompani e cila ka kërku që ta grumbulloj me një vend, pastaj kur të kryhen punimet e shkollës me hjek, por shikone gjendjen se si duket aborri i shkollës mes 2 shkollave. Kërkoj edhe për këtë rast të ndërhyhet urgjentisht. E di që drejtorja e “Kongresit të Manastirit” kishin kërku me mbledh një fond për me hjek atë, por unë ju bëjë ftesë prindërve mos të japin pare, se këtë deponi e ka shkaktu një kompani që e ka obligim me hjek prej aty. Tjetra pyetje ka të bëjë me kanalizimet në Pozheran. Unë e di që se përgjegjëse është “Hidromorava”, por çdo reshje qoftë dhe më e vogla në Pozheran, lagjja “Zuka” dhe një pjesë e lagjes “Pira”, një pjesë që kanë podrume kanë shumë probleme. Për këtë janë të njoftum drejtori i shërbimeve publike, “Hidromorava”. Besoj që atyre qytetarëve duhet të ju bëjmë zgjidhje. Nënkryetar, gjithashtu kërkoj një bashkëpunim më të mirë me policinë, se në kohën e fundit njerëzit të pandërgjegjshëm janë tu sillë nëpër oborre të shkollave dhe janë tu përdor landë narkotike. Para disa muajve ne kemi pas këtë problem në Pozheran. Po, tu ju falenderu policisë, i

kanë nuan. Besoj që edhe në shkollat tjera është i njëjti problem, që më kanë kërku me ngritë si shqetësim në kuvend.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetjen e parë e kam për komunën. I kam nxjerrë disa prej kontratave të mëhershme, diku prej viti 2018, por unë do të fokusohem nga viti 2021, kontratat për hartimin e investimeve kapitale për Komunën e Vitisë, 2-vjeçare. E para, shuma 180 mijë euro, me 24 mars 2021 dhe përfundon me datën 23 mars 2023. Shuma është 180 mijë euro për hartimin e projekteve për Komunën e Vitisë. Kontrata e dytë është me 8 mars 2023 dhe përfundon me datën 7 mars 2026. Shuma është 360 mijë euro. Kontrata e tretë, dhe kjo hartimi i projekteve të investimeve kapitale për Komunën e Vitisë, e cila është nënshkruar pa përfunduar ajo e para, por tash kërkojmë sqarime, me 30 korrik 2024 dhe përfundon me datën 29 korrik 2026. Shuma është 300 mijë euro. D.m.th kur të mbledhësh si total për 4 vite, deri 2026, i bjen, 5 vite Komuna e Vitisë jep 844 mijë euro për hartimin e projekteve, dhe ne e dimë se si janë projektet edhe gjatë implementimit që intervenohet në shumë gjëra për ta përmirësuar vetë hartimin e projektit, dhe kur është një shumë 844 mijë euro për projekte, për 5 vite në komunën tonë, kisha kërku sqarime, me i ditë cilat projekte. Nëse nuk ka mundësi sot përgjigjja e lajm për muajin tjetër, por me ditë cilat projekte janë hartu me këta tenderë që janë dhanë. Pyetja tjetër lidhet me Ilirin. A keni informacion, sa nga objektet në Komunën e Vitisë pikojnë, se është si shqetësim kjo. Unë po i ceku disa që vetë kam qenë i kam vizitu, shkolla në Sodovinë, shkolla në Pozheran, shkolla pas ETC-së në Viti, shkolla në Drobesh. Janë këto që i di vetë, i kam parë se edhe për tjera kam ndëgu.

z.Nexhat Halili: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime ka të bëjë rreth ujit të pijes, me gjithë premtimet që uji i pijes në Komunën e Vitisë do të jetë prioritet kryesor në këtë komunë. Si duket kjo ka dështu. Në disa lokalitete ka kohë që janë instaluar rrjetet të ujësjellësit, por të cilat nuk kanë ujë të pijes. Në disa funksionojnë ujësjellësit të cilët kanë ujë, por uji përdoret vetëm për amvisri ose për ujtitje, ndërsa disa ujësjellës të tjerë nuk kanë as unë. Rasti konkret është i ujësjellësit 5 fshatrat: 2 Sllatinat, 2 Sodovinat dhe Tresteniku. Në Buxhetin e Komunës së Vitisë është planifikuar që gjatë vitit 2025 të shpezohen diku afër 40 mijë euro për rivitalizimin e këtij projekti, dhe në planifikimin e prokurimit për vitin 2025, është planifikuar të udhëheqet kjo procedurë e prokurimit deri që është paraparë të inicohet me 17.03.2025, por ende në këtë drejtim nuk ka kurrfarë hapi. Strukturat udhëheqëse kanë pas edhe një takim me udhëheqësit e kompanisë “Hidromorava”, mirëpo deri më tani nuk shihet kurrfarë hapi në këtë drejtim, kur do të fillojnë këto procedura dhe kur do të përfundojnë, që në të ardhmen të paktën këto 5 fshatra të kenë ujë të pijshëm, ndërsa rreth ndërtimit të trotuarit dhe ndriçimit publik, projekt dyvjeçar, kontrata është lidhë me datën 27.10.2021 deri me 25.10.2023, kontrata dyvjeçare, vlera e tij, krejt projekti është 820 mijë e 153.13 euro. Në këtë kontratë janë të përfshira shumë projekte nëpër fshatra të ndryshme. Disa projekte janë përfunduar, disa janë në proces të implementimit, mirëpo në kontratë përfshihet edhe trotuari i fshatit Trestenik, i cili ka fillu gati që tri vite, dhe ai ende nuk shihet se kur do të përfundon. Ky trotuar ka gjatësi 2746 metra, gjërësinë 1.2 metra. Vlora e vetme e këtij projekti është 84 mijë e 153.84 euro. Kontrata e këtij projekti vetëm ka përfunduar. Nuk e di unë tash se në të ardhmë se si ka me vepru në këtë drejtim. Tani në vitin e kaluar është lidhë kontrata tjetër për vazhdimin e trotuarit, i cili ka gjatësinë 725 metra. Punët kanë filluar, por punët menjëherë janë ndërprerë. Nuk e di arsye pse janë ndërprerë. Kërkoj që ky projekt të vazhdoj, edhe një projekt tjetër i cili e lidhë prej rrethit të fshatit Trestenik, e kalon nëpër lagjen “Shkodra” të fshatit Sadovinë, e cila e lidhë rrugën Sadovinë – Sadovinë. Ky trotuar, edhe në kuadër të këtij trotuari është edhe ndriçimi publik. Besoj se është shumë i nevojshëm dhe do të jetë prioritet për qytetarët e këtyre lokaliteteve, sepse lagjia “Shkodra” në Sadovinë të Muhagjerëve”, si duket është lënë në mëshirën e fatit. Deri tash nuk shihet që punët janë në drejtim. Edhe një pyetje. Asfaltimi i rrugës Sllatinë – Viti. Në këtë asfaltim del se, vitin e kaluar kanë përfunduar punimet. Deri më tani në këtë rrugë është intervenu dikun 28 pozicione, e po të dilet në këtë rrugë të shifet kjo rrugë, ka nevojë për me intervenu edhe në 28 pozicione të tjera në këtë rrugë. Për këtë rrugë kërkoj që të planifikohet një trotuar dhe ndriçim publik, se kur të bëhet ndriçimi publik, atëherë shihet më mirë rruga se në çfarë gjendje është. Edhe në kuadër të kësaj rruge është parapa të përfshihen edhe shenjat e komunikacionit, shenjat e rrezikut, shenja rrethore dhe formë katërkëndëshe. Deri më tani nuk shifet asnjë shenjë e komunikacionit

që është vendos në këtë rrugë. Pyetja është, kur do të përfundojnë këto rrugë dhe kur bëhet pranimi teknik i kësaj rruge.

z.Musli Neziri: Përshendetje të nderuar të pranishëm! Pyetjen e parë e kam rreth kontratës për shërbime nga kompania “Kosova Med” për punësimin e familjarëve, e klaneve të caktuara, ku nuk dilet fare ndoshta në punë, ku nuk dilet jashta shtëpisë së bardhë, rrethit të ngjashëm që i takon kryetarit Haliti, duke e ditur që kem ndoshta anëtarë shumë të devotshëm të partisë së LDK-së, ndërsa të ri e të reja sjellen rrugëve, po e marrin kontratën, e ata të cilët janë vetëm klanet e caktuara, ku shpërndahen kontratat në zyrën e DKA-së, >>ja kontratën e ju votën<<, ku shfrytëzohet anëtarësia e njerëzve të caktuar, duke shfrytëzuar lidhjet familjare të punësimit të familjarëve të drejtorëve, familjarët e asamblistëve. Ne e dimë që të gjithë ndoshta kanë nevojë për punësim, sikur të punsohet njerëzit e meritum, qoftë subjektit LDK, nuk do ta ngjersja këtë shqetësim fare, sepse është e kuptueshme që, njerëzit kanë nevojë për punësim, por nuk është mirë që të bëhen kësi selektime, prandaj kërkoj që të bëhen publike lista se kush është punësuar ose kush ka marrë kontratë të punësimit nga kompania “Kosova Med”. Thjeshtë, për ta pas një transparencë se kush paguhet nga taksat e qytetarëve të Komunës së Vitisë. D.m.th të dihet publikisht nga të gjithë. Pyetjen tjetër e kam rreth shqetësimit për trotuarin në rrugën “Agim Ramadani”. Aty kërkohet që të dilet në teren, qoftë nga inspektoriati, apo të cilët janë kompetencë. Aty trotuari ka shumë pengesa, ka hapësirë trotuari që është vetëm 40 cm, ka punësime që është blloku komplet trotuari, që nxënësit kalojnë në rrugë me hecë, që është e rrezikume ajo, edhe është bërë me 2 kahje dhe është e ngushtë rruga pak, dhe në trotuar janë vendos pengesa. Atëherë aty duhet të ndermirren masa, ndërsa pyetjen që lidhet me këto pengesa, nënkryetar, tu kisha drejtu dhe juve, gjendjen në kyqjen e rrugës magjistrale Klokot – Gjilan, e që kanë lanë konkretisht në rrugën në Klokotit, se si ka mbet aty kyqja. Ajo rrugë është për mjerim. Unë nuk e di kompania që e ka kry atë asfaltimin e rrugës regjionale, por se si e ka lanë komplet atë zonë, qytetarët që lidhen aty në asfalt kur të kyqen në rrugën e Vitisë, është mjerim dhe për keqardhje komplet ajo zonë e atyre banorëve që janë tu lidhë në atë rrugë. Të njëjtin shqetësim e kemi edhe si ka mbetë kyqja në Klokot. Dy fshatra: Zhiti dhe Ballancë, nëse dilni jepni një gjiro me automjet keni me pa që ajo paraqet rrezik permanent për aksidente. D.m.th, rruga kur është bërë niveli i asfaltit ka mbetë lart, kyqja ka mbet e vjetër, ka mbetë për keqardhje.

z.Sokol Shaqiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë sot kam një rast më të veçant. Besoj që shumica juaj jeni në dijeni që, në muajin e kaluar një terrorist i cili na e ka sulmu shtëpinë. Unë dashta përmes kuvendit komunal të ju drejtohem organeve të drejtësisë, që mos ta neglizhojnë rastin, sepse është një rastë serioz, dhe arsyen pse ka ndodhë deri këtu nuk e dimë. D.m.th e ka sulmu shtëpinë e djalit të vllaut. Unë ju garantoj me jetë që, djali i vëllaut kurr nuk ka pas me askënd problem, edhe caku ka qenë krejt tjetërkujt, d.m.th edhe një here i bëjë lutje organeve kompetente, që mos ta neglizhojnë rastin, se bëhet shumë vonë, dhe për atë urdhëruesin e kam një mesazh: ai që ka dhënë urdhër me pagesë, mos të mendon se na frikon. Nëse ka diçka, ne jemi këtu dhe ne të më delë përball, sepse nuk ka të drejtë me sulmu pronën e dikujt. Ju kërkoj ndjesë, por mesazhi im është për organet e drejtësisë, kur ka mujtë me pagu personi me ardhë mes natës me gjujt me kallashnikov me 11 plumba, edhe mundet me neglizhu, me bë pagesën diku tjetër. Unë edhe prej organeve komunale nuk e kam parë askënd, një mesazh me dhënë dhe me dënu këtë rast. Në të jetë në ndërgjegjen e tyre.

z.Bekim Azizi, kryesues: Unë shfrytëzoj rastin prej pozitës së kryesuesit të kuvendit të dënojme këtë akt të sulmit mbi shtëpinë e familjes suaj, dhe kërkoj nga organet kompetente, sepse vetëm organet kompetente janë ata që merren me këto raste kuvendi nuk ka mundësi me u marrë, mirëpo organi kompetentë të merret seriozisht me këto raste dhe të bëjë zbardhjen e këtyre rasteve.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I nderuari drejtor i inspeksionit, unë sot po e shof që drejtori i inspeksionit është këtu dhe po e nijmë nëpër rrugë që është bërë drejtor i inspeksionit, d.m.th drejtori kur të emrohet është faqja publike e komunës, e cila kur të bëhet drejtor ajo e qetë njëfar lajmrimi. Këtu bëhen drejtorat veç kur ti shohim. I nderuari z.Muslia, urime detyra e re. Unë në seancën e kaluar kam folë për ndërtimet në Komunën e Vitisë. Unë edhe një here po themë sot, pasi je prezent unë nuk jam kundër ndërtimeve. Vitia ishalla lulëzon prej ndërtimeve, se ndërtimi është i mirë, i shëndetshëm, progresim, por edhe një here po ta bëjë ty një pyetje, edhe nënkryetarit të komunës për ditë, ndërsa si këpurdhat janë bërë. A janë tu e plotësu ndonjë

kriter, a janë tu e marrë ndonjë leje a veç janë tu ndërtu si në Falluxha e Pakistan, pa kurrfarë kritere të nderitmit. Drejtoria e Inspeksionit po më duket që është shumë pasive rreth ndertimeve. Më herët keni dënu njerëzit për shtëpia, e sot ata që po ndërtojnë pa leje edhe po prishin shtëpia, dhe po na bëjnë faqe të zez krejt Kosovën, po na qesin tu prish shtëpinë pa ndonjë shirit apo polic, veç kerret kalojnë aty prishen. Unë nuk e di kjo drejtori a është tu ekzistiu, a është pasive. Këtu kush donë ndërton, kurrfarë kriteri nuk ka. Unë nuk jam kundër ndertimeve, veç po du më ditë prej juve a vjenë dikush me u konsultu me juve për me marrë leje, a këtu në Viti veç e blen dikush shtëpinë, merret vesh me pronarin e shtëpisë dhe e prish e ndërton. Këtu a ka ligj, a ka shtet, çka ka këtu, a veç i keni me i punësu njerëzit përmes "Kosova Med-it" dhe me i marrë njerëzit në pyetje nëpër zyre, pse nuk më keni votu, duheni me më votu ja u bëjë kontratat. Duhet me pas ligj more, por ishalla qytetari ja tregon vendin. Tash janë zgjedhjet pas 7 muajve dhe nuk ju shohim më në pushtet.

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nuk më duket fare në rregull që, në çdo seancë të kuvendit komunal, ku ne diskutojmë pyetje dhe çështje, kryetarin e komunës nuk e kemi prezent. Tash edhe mundem me kuptu që, ndoshta e ka problem me marrë veten pak prej zgjedhjeve që kanë qenë, mirëpo në fund kryetari i kuvendit duhet me ditë faktin që, propozim vendimet legjitimohen pikërisht prej nesh, prej asamblistëve të kuvendit komunal, mirëpo kohëve të fundit e kemi parë që kryetari i komunës është tu e luajt rolin e gjyqtarit, me i marrë në pyetje qytetarët që e kanë votu edhe që nuk e kanë votu, edhe ata me i ndëshku e të tjerët me i shpërbly me pozita dhe vende pune, mirëpo nuk po më duket fare në rregull ne me përmend në çdo seancë e ai mos me qenë fare prezent. Andaj, unë kisha kërku që në të merr guximin në të merr pjesë në kuvend dhe të ballafaqohet me pyetje, me çështjetë, sidomos projektet të cilat i udhëheq pikërisht i pari i komunës. Tani po kthehem tek çështjet që dua ti ngris. E para ka të bëjë me shqetësimin e vazhdueshëm të qytetarëve të Komunës së Vitisë për mungesën e shërbimit të barnatorëve. Gjatë natës është problem që qytetarët e Komunës së Vitisë e kanë të vazhdueshme. Unë nuk e di a duhet me diskutu akoma rendësinë për jetën e qytetarëve se sa është i rëndësishëm shërbimi 24 orë farmaceutik, dhe prej kujtë po presim ne që ky problem me u zgjidhë. Pyetja ime është për drejtoreshën, mirëpo edhe për nënkryetarin me ditë se deri kur ka me shku ky problem apo deri në pafundësi nuk ka zgjidhje. Qytetarët e Komunës së Vitisë detyrohen për një shërbim më të thjeshtë, qoftë për një shërbim që i duhet me shku në Gjilan apo Ferizaj për barnatore, e Komuna e Vitisë mos me pas barnatore në shërbim 24 orë në Viti. Nuk e di a ka mbetë ndonjë komunë në krejt Kosovën apo është Komuna e Vitisë e cila e ka të vetmin këtë problem, dhe askush nuk merret me të tash. Nuk po e kuptoj a është në interes të kryetarit me i ndegju këta qytetarë apo thjeshtë nuk ka përfitim aty. E dyta, është kërkesa e vazhdueshme e grupit tonë, sidomos në KPF prej meje dhe kolegut Jakupit, ku për 7 muaj rresht ne kemi kërku me u sjell një raportim i investimeve të punimeve që bëhen në Komunën e Vitisë, të cilat kanë pranim dhe nuk kanë pranim teknik. Kanë kalu 7 muaj dhe akoma ai raportim nuk është sjellë. Sot ne kemi në pikë të diskutimit pikërisht kontratat që janë nënshkru për 3 vite e ku shumica prej tyre nuk kanë fare pranim teknik. Tash pyetja ime është: pse nuk e keni sjellë atë dokument? A nuk jeni në gjendje me përgatit një dokument të raportimit apo thjesht nuk po ju konvenon me shfaq para qytetarëve? Shumica e punimeve që bëhen në Komunën e Vitisë janë pa kurrnifar kriteri, janë pa pranim teknik, e këtu mundemi me folë për rendësinë që ju po ja jepni pikërisht projekteve të cilat bëhen në Komunën e Vitisë shkel e shko. Tjetra është për administratorët e fshatrave. Këto ditë është dalë një hulumtim i cili është bërë, ku prej 37 kërkesave të cilat administratorët e fshatrave i kanë ngrit në dëgjime buxhetore, vetëm 13 prej tyre janë marrë parasysh, fakt që po besoj që, gjithsecili prej neve e kemi ditë. Unë po e përmend këtë për 2 arsye: e para është me shfaq pikërisht atë mënyrën se si trajtohen administratorët e fshatrave prej të parit të komunës, ku i merrë, i fton në dëgjime buxhetore, e në fund për krejt projekte që bëhen në Komunën e Vitisë vendos krye në veti, nuk e pyet askënd. Dhe tjetra është, e dimë që këshillat e fshatrave, administratorët e kanë kalu mandatin e tyre, andaj unë këtu po e bëjë prapë një thirrje që, është mirë me u përgatit procesi i ri zgjedhor, edhe thjeshtë me ju kushtu një rëndësi me e veçantë këshillave të fshatrave, dhe mënyra e trajtimit me qenë e duhur. Është një kërkesë që ka bërë Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve në Viti, kërkesë për vendosjen e kamereve në hapësirat e banesave. Po besoj që nënkryetari e ka marrë kërkesën dhe drejtori përkatës. A është parapa me u marrë ndonjë masë rreth kërkesës së tyre? Po besoj që jeni në njohuri për kërkesën e tyre.

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Kam disa kërkesa dhe shqetësime të qytetarëve të Vitisë. Njëra është një shqetësim i banorëve të fshatit Devajë, e që plotësisht e arsyeshme në hymje të fshatit Devajë është bërë pothuajse tmerr prej mbeturinave të vrazhda që i qojnë prej të gjitha fshatrave. Aty pos vendit të caktum që është leju me i hudhë mbeturinat deri te rruga poshtë thuajse zvarrë kanë shku mbeturinat e vrazhda, edhe pse pak banorë aty me atë gjendje si janë. Në fakt po dojmë me i shpërngul krejt. Unë mendoj që urgjentisht duhet me ndërmarr masa me i largu ato mbeturina, se përndryshe gjendja ish shumë e neveritshme edhe për një musafir me shku e leje më për banorët që shkojnë për çdo ditë aty. Mbeturinat me një vend duhet të hedhen, por të gjendet një grop jo bash në kodër, në hymje të fshatit. Tjetra ka të bëjë me shqetësimin e taksive këtu tek posta e dimë që taksit e kanë një biznes familjar, sado pak mbijetojnë me të, mirëpo ishin 2 shenja të vendosura në qoshe, mirëpo kërkesa e tyre është që edhe në rrugë, në asflat të shkruet që të mos kenë ngatrra me qytetarët, se shumë herë po ju rake me u ngatrru, se qytetarët i parkojnë veturat, ja nxajnë vendet dhe këta detyrohen me pas edhe ngatrra, gjë që unë mendoj urgjentisht duhet me zgjidhë këtë problem. Një shqetësim që ka qenë më herët, e kam diskutu edhe më herët një rregullore për sistemimin e vendeve të punës. Pse nuk është bërë ende në Viti? kur dihet që për të njëjtën punë shumë punëtorë marrin paga të ndryshme, d.m.th nuk paguhet njëjtë. Mendoj që kjo punë duhet me u kry, se mundemi me hy dhe në gjynah, por nuk është edhe e drejtë që me kry të njëjtën punë e me u pagu ndryshe. Duhet me pru atë rregullore në kveund, me kalu, me sistemu taman qysh duhet. Dhe një pushimore e busit në Gërmovë, te rruga e Goshicës. E kam përmend edhe më herët, makinat shumë here po ndodhë që me i dëmtu. Është prish parkingu, kemi thanë që kemi me marrë një përgjigje pozitive, ende është në atë gjendje si është, edhe me dashtë dikush me i marë qytetarët nuk po mundet me u ndalë aty shkaku që është deformu dhe dëmtu tepër shumë ajo pjesë. Kërkoj dhe kjo të kryhet, se është në interes të përgjithshëm të qytetarit të komunës sonë.

znj.Liridona Bislimi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Çështja e parë ka të bëjë rreth banorëve të fshatit Letnicë dhe Stubëll. Dje kemi diskutu paraprakisht me drejtorin e shërbimeve publike, mirëpo është një problematikë të cilët banorët i ballafaqon për një kohë të gjatë. Sahere që bie një rigë e vogël shiu, d.m.th ato ansoret që janë në rrugën kryesore e bëjnë rrugën të pakalushme. Në këtë mënyrë pra e kuptoni problemin dhe rrezikun që i kanoset këtyre banorëve saherë që e kalojnë këtë rrugë. Tani unë e di që mundeni me ma dhanë përgjigjen që kjo rrugë ndoshta investimet e shërbimet kryhen prej nivelit nacional, mirëpo kjo problematikë është prej një kohe të gjatë, prej fillimit. Ndoshta ju është dashtë me pas edhe më herët biseda me ta, ankesa, po du me ditë se si qëndron kjo çështje, pse ka ardh deri këtu. Dje kanë dalë banorët e kanë pastru vetë rrugën, por nuk është zgjidhja te pastrimi. Ju duhet me bë një zgjidhje më adekuate, më afatgjatë, për shkak se me të vërtet është një rrezikshmëri e madhe që dikush me kalu te poshtë, te pjesa e lumit, kështu që ta bëjmë një zgjidhje nënkryetar, para se me mbërri te ndonjë çështje më serioze. Tema tjetër që dua me diskutu është shumë më e ndjeshme, po më vie keq nënkryetar, se çdo here po më thu që po merresh vetëm me kryetarin, mirëpo sinqerisht kjo çështje është për të. Me datën 16.12.2024, Sokol Haliti e ka pranë këtë kërkesë e cila nder të tjera thuhet se, sektori i gjendjes civile kërkojnë nga institucionet e lartcekura, që ta bëjnë rregullimin e koeficientit të pagës në harmoni me katalogin e pagave për shërbyesit civil, duke kaluar nga profesional 3 në profesional 2. Deri më tani nuk është ndërmarr asnjë hapë, bëhet fjalë për 50 punëtorë, 50 familje të Komunës së Vitisë, të cilët e marrin pagën e nivelit më të ulët. I nderuari nënkryetar, ne si Komunë e Vitisë, e vetmja në nivelin nacional jemi pas përball me një far problematike, ku shumë pak keni pas mujtë me ndërlidh nivelin nacional. Çka nëse kish ndodh që ky problem kish pas pak a shumë lidhje me nivelin nacional, çka kish bë Sokol Haliti. Ta tregoj unë. Kish bë protesta vazhdimisht, reagime për me përfitu politikisht. Tash këtu leje që nuk mundet me përfitu politikisht, por as nuk ua ka kthi njerëzve përgjigjen. Tash a po e kuptoni çështjen se çka shohim ne opozita, që ju nuk po doni me pa. Tash edhe këta janë punëtorë të Komunës së Vitisë njëjtë sikur ata të arsimit. Pse me ndodh me vepru kështu me këtë kategori, për shkak që këta i kryen shërbime jashtëzakonisht të rëndësishme, janë shërbyes civil. Po na duhet me ditë se çka keni me bë konkretisht, se ata nuk e dinë, d.m.th i kanë paralajmru dhe me bë protest. Deri aty ka mbërri çështja e tyre, për shkak që paga që e marrin ata nuk i dalin as për shërbime elementaret të një dite, të një punëtori të mirëfillt, se kanë me bë rrugë, kan me hanger ushqim e kanë shpenzime tjera. Po flasim

për një periudhë që ka më shumë se 1 vit. Ky është skandali i Sokol Halitit aktual. Nuk po du me marrë një përgjigje që ndodhë zakonisht qysh thashë: jo jemi tu mundu me rregullu. Veç kërkoj që me gjetë një zgjidhje afatgjate kushdo që mundet.

z.Bekim Azizi, kryesues: Faleminderit Liridona! Ligji i pagave i përcakton për secilën kategori. Nëse ka ndonjë gabim, ndonjë lëshim, duhet të rregullohet.

znj.Liridona Bislimi: Ky problem nuk është i problemit nacional, për shkak që jam interesu. Gjilani, Ferizaji nuk e kanë, vetëm komuna e Vitisë.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pyetja ime e parë është për drejtoreshën e shëndetësisë. Drejtoreshë, në seancën e parafundit është bërë temë punëtorët në QKMF me kontrat në vepër që kanë qenë. Po më intereson, është nënshkru kontrata e re me "Kosova MED-in". Kthimi i atyre punëtorëve kishte me qenë shumë i mirë, pjesa e tyre dërmuese kanë nevojë dhe ndoshta atë pagë e kanë ekzistenciale. Pyetja është direkte: a janë kthi të gjithë apo janë kthi në mënyrë selektive? Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e inspeksionit. Njëherit dhe i uroj postin e drejtorit. Drejtor, deponitë ilegale janë bërë tmerr në Komunën e Vitisë. Më ka rastisë, vetë e kam parë punëtorin e Drejtorisë së Inspeksionit duke i evidentuar deponitë ilegale. Po më intereson: a ka mbërri me evidentu një numër të sakt dhe me ditë lokacionin ku janë dhe me u ndërmarr ndonjë intervenim që, ato deponi të pajisen me kamera, të jenë në vëzhgim, sado kudo ta ruajmë këtë ambient? Se nëse vazhdon kështu, vajë halli për neve.

znj.Zejnepe Osmani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kohëve të fundit unë kam hasë shumë dëmtime të dritave të qytetit, sidomos ka pjesa ka lumi "Morava". Aty kam parë shumë dëmtime të cilat janë hedhë dhë në lumë. A është zbulu ndonjëherë ndaj këtyre dëmtimeve që kanë bërë këta persona të pandërgjegjshëm? A kanë bërë zbulime të këtyre personave? Sepse shpeshherë ka ndodh dëmtimi i këtyre dritave të cilat i kam parë vetë unë aty. Ndodhin shpeshë këtu, sidomos në lumin "Morava".

znj.Merrushe Ahemti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pyetjes së z.Aliut, në raport me "Caritas Kosova", se "Medika Kosova" nuk ka të bëjë me drejtorin time, meqenëse nuk jam nënshkruese e kontratës, nuk kam qenë pjesë e takimeve, normalisht që nuk kam qasje me pa dhe listën e stafit, dhe si e tillë nuk e konsideroj kompetencë të jap një përgjigje të tillë, përderisa nuk kam qasje në dokumente të tilla. Ndaj, pyetja është e adresume gabimisht. Ndërsa sa i përket pyetjes së Majlindes, në lidhje me barnatoret. Barnatoret janë sektor privat, që normalisht ata e ndjekin interesin e tyre, dhe normalisht që demografia e secilës komunë i përcakton edhe politikat e tyre, mirëpo unë normalisht që jam e hpaur me zgjidh si çështje. Janë disa komuna që e kanë zgjidh si çështje përmes subvencioneve të ndryshme, mirëpo unë nuk jam autorizuese kryesore e buxhetit të komunës, atëherë si e tillë nuk kam kompetencë me nda, mirëpo normalisht nëse ka vullnet me zgjidh këtë çështje më se të nevojshme, dhe pajtohem me gjithë që, duhet me e zgjidhë çështjen e barnatatoreve.

z.Basri Aliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Rreth shqetësimit të kanalizimit në Pozheran, Ilir, kanalizimi ti vetë e the që është nën mbiqyrje të "Hidromoraves", që ata e kanë obligim, por sigurisht gjatë të reshurave ato po kanë telashe, se edhe në seancën e kalume e përmenden se, edhe ujërat atmosferik po i vendosin në kanalizime. Kështu që, po vjen deri te mbushja e tyre dhe po dalin mbi sipërfaqe, por po kalojnë edhe në podrume të shtëpive. Për mbeturinat në Devajë, e përmendi Sejda, atje është një deponi e cila është caktu në bazë të kuvendit, si vend deponie për mbeturina inerte, por e kanë tejkalu dhe kufinin. Realisht nuk është vend i duhur ku e kanë caktu, por kështu ka qenë përmes kuvendit. Sigurisht tash ndoshta me harta zonale edhe me PZHK sigurisht jan caktu dhe vende tjera që mund me hedhë. Unë kam bërë dhe një kërkesë dhe në Agjensionin e Pylltarisë, që të na e lejojnë mundësisht, se ajo grupa te varrezat e Radivojcit dhe Budrikes që paraqet dhe rrezikshmëri, por janë pronë e Agjensionit të Pylltarisë, kështu që na nuk kemi të drejtë. E kam bërë kërkesën, shohim se çfarë përgjigje po më japin, se ajo do të ishte adekuate dhe me i ik rrezikut me mbulu atë, por edhe me rikthi në gjendje më të natyrshme. Ne veç kemi qenë në vend të ngjarjes atje, së bashku me drejtorin e inspeksionit dhe kryetarin, dhe kemi marrë një qëndrim që, duhet ta vorrosim ose ta largojmë prej atyhit këtë deponi. Për taksit që the, kam pas biseda dhe me ta, por vetëm po presim që në procedurë është kontrata për sinjalistik, në mënyrë që kur të vendoset, d.m.th bëhet kontrata, ne sigurisht do të intervenojmë, do t'i shenojmë

aty sikurse kemi vendos dhe tabela vertikale, është vendi i tyre. Ndërsa për pushimoren në Gërmovë, ne do të shohim, por kjo është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, sepse rruga përgjatë, d.m.th prej Vitisë-Kllokot- Gerlicë, ato i mbikëqyrë Ministria e Infrastrukturës. Në qoftë se ata fare nuk intervenojnë, atëhere ne shohim, por sipas bisedës, ata kanë thanë që ka maji fillojnë me interevenu, sepse janë bërë dhe disa vrima të cilat i kam paraqitë, po përgjigjja tyre ka qenë që, vetëm në maj intervenojmë, atëhere shohim. Ndërsa për rrugën në Letnicë, ne kemi pas një bisedë dhe vetë e the që, ajo është rrugë rajonale, e cila edhe ajo është nën mbikëqyrje të infrastrukturës. Ne kërkesën ja u kemi dërgu dhe shqetësimin ja kemi ngritë edhe më herët, jo vetëm tash, që duhet të intervenohet, sepse çdo reshje që ka, bien gurë dhe paraqesin një rrezikshmëri. Tash ata veç e kanë kërkesën, por edhe përmes letrave ja kemi dërgu, por vendimi i tyre është se, çka do të ndërmarrin në këtë ndërtim. Ndërsa për demolimin e ndriçimit që e ngriti si shqetësim, është shumë e vërtet, prej njerëzve të pandërgjegjshëm, ndoshta edhe prej të rinjve që po themë që frekuentojn aty, po bahet ky dëmtim, por jo vetëm aty, por dhe në vende të tjera. Ne vetëm kemi fillu me i vendos të tjera për atë që a e kanë gjetë dikënd, është kompetencë e Policisë së Kosovës. Në shqetësimin e kemi ngritë te ta, dhe ata do të merren me këtë punë.

z.Ali Bajrami: Drejtoreshë, në bazë të njohurive që kam, dhe në bazë të përgjegjësi, të kompetencave ligjore që i ke, QKMF dhe AMF janë nën menaxhimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, me u shpreh në atë mënyrë që, pyetjen e kam drejtu dhe e kam bërë gabimisht. Veç edhe një nuk e the se, ku duhet ta bëjë atë pyetje. Unë po mendoj që, pyetjen e kam bërë në adresë të duhur dhe aty ku duhet, edhe përgjegjësi dhe kompetencë si drejtoreshë, edhe AMF dhe QKMF janë nën menaxhimin dhe kompetencën e juaj. Prandaj jam i sigurt që, pyetjen e kam bërë aty ku duhet. Nëse ti nuk ke qasje, ato janë probleme të organizimit të juaj të brendshëm dhe me struktura tjera.

znj.Merrushe Ahemti, drejtoreshë: Po e shof që ka pas një keqkuptim. Kontrata e Caritasit dihet botërisht që është e nënshkrume mes kryetarit të komunës dhe operatorëve ekonomik, dhe si e tillë, meqenëse nuk jam nënshkrues, nuk mundem me ditë çka përmban dokumenti, dhe si e tillë Caritasi ka një listë të madhe të stafit që është e pamundur një person me nxjerrë konkluzë të tillë, për me ditë në bazë të çfarë procedure të rekrutimit është bërë ai staf. Unë nuk e konsideroj jetike, as profesionale me dalë me konkluzë të tilla, një person për me arritë me i identifiku mbi 100 persona, se në çfarë mënyrë është bërë rekrutimi, përderisa unë nuk kam listë të stafit momentalisht. Cili është numri i stafit? Përderisa nuk kam qenë pjesë e takimeve, konsideroj automatikisht çështje që nuk më përket mua. Le të flasim njerëzit që e kanë nënshkru, njerëzit që e kanë listën e stafit, ata mundën me ti dhanë këto informacionet. Si e tillë, unë nuk marrë përgjegjësi, përderisa nuk kam qenë pjesë e takimeve dhe bisedimeve të tilla, me gjithë përgjegjësinë e plotë të fjalës.

z.Bekim Azizi, kryesues: Ali, dije që, drejtorja dhe QKMF nuk bashkëpunojnë. Drejtoresha është e lidhur drejtpërdrejt me ekzekutivin, me kryetarin, nënkryetarin, dhe asnjë qasje, asnjë raport kurr me drejtorin nuk e kanë. Thjesht është një mbikëqyrje që e bëjnë këta në vete. E din ti mirë.

z.Ilir Zuka: Për tek problemet e kanalizimeve, ne e dimë drejtor që, shumë vite është i njëjti problem. Kërkesa e asaj lagje, konkretisht është me bë një kanalizim të ri prej 200 deri 250 metra, të jesh i bindur që ka me e sanu atë problem, dhe s'ka me ndodhë më. Kjo është mundësia bashkarisht me "Hidromoravën", se ata kanë qenë disa here dhe kthehen pa bë zgjidhje. Problemi e dimë që i takon "Hidromoravës", por lidhja kryesore që është bërë aty për me qitë te kanalizmi kryesor është 200 deri 250 metra, dhe po besoj që ai problem ka me u zgjidhë.

z.Basri Aliu, drejtori: Ilir, për këtë pasi që unë e kam veç mirëmbajtjen, kjo po delë si projekt i ri, por e kemi Xhelalin këtu, i cili e merrë parasysh këtë dhe a është mundësia që me kontratën që është për kanalizime për me bë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshendetje për të gjithë të pransihmit! Respekt për të gjithë këshilltarët e kuvendit komunal, për shqetësimet të cilat i kanë ngritë, edhe pse gjithëhere po kërkohet, apo po aludohet, se ne e dimë përgjigjen. Unë përgjigjen e jap nga të dhënat të cilat i kam dhe nga prezentimi i ekzekutives. Gjithëhere duhet me kuptu se, ndoshta jo për qefi të dikujt apo të këshilltarit të kuvendit komunal, sikur që pyetjet e juaj të cilat i bëni, mund të ndodhë që mua nuk më pelqejnë, por megjithatë ti je këshilltar i kuvendit komunal dhe i bënë në atë adresë. Dhe e dyta çështje, të cilët ju jeni dëshmitar, sikur unë ndoshta jo

drejtpërdrejt, por jeni dëshmitar të kohës të cilët po e shihni ekzekutimin e landeve që burojnë nga kontratat kolektive, dhe prandaj shumica e projekteve, të cilët shtyhen në këtë drejtim. Janë pikërisht këtu si shumicë. Mund me qenë ndonjë pjesë tjetër, po 95-97% e përfshinë ajo dhe një kontratë kolektive, e cila po ekzekutohet nëpër krejt komunat. Unë po flas për Komunën e Vitisë, i ka prishë shumë here edhe parashikimet e kryetarit, por edhe të buxhetit të cilin e kemi propozu para jush dhe e keni aprovu ju. Prandaj pikërisht ai është qelsi i disa vonesave të cilat unë e di se Nexhati i shtroj në atë drejtim, dhe çka është më e keqja e mundshme, nuk du me akuzu askënd, se tash me akuzu ju që e keni pushtetin qendror, thu pse por kjo po ndodhë. Kompanitë po arrijnë me deportu në Ministri të Financave dhe po thotë ti mos e nis punën se ty ti kemi marrë paratë. Edhe me kësi gjëra po ballafaqohemi. Këtë ja u dëshmoj sahere du, që i ka informacionet shumë më të plota, se vetë kryetari, edhe ti në projektin tanë të cilin i ke pas të parapame paratë, ti kemi marrë, dhe tashti urdhno çka ki me bë në këtë situatë. Ilir, do të bëjmë përpjeke maksimale, se ti e dinë, ai ka qenë projekt i ministrisë, pa dashtë me akuzu askënd, megjithatë duhet të shikohet garancioni i kryerejs së punëve, dhe në kuadër të garancionit të bëjmë diçka me çështjen shkollës. As nuk du të lidhem me atë që tha Jakupi si refleksion, sa shkollla tjera pikojnë, gjithësecili ka problematikën e vetë. Tash këtu mdoket kjo duhet me pas garancionin, se nuk i ka 3-4 muaj me siguru. Garancionin e ka 1-vjeçar. Duhet me kontaktin inxhinierin, dhe pas takimit do ta thirrjmë dhe me shiku çka ka mundësi. Në atë drejtim do ta thirrni drejtpërdrejt për çështjen e deponisë nënkontraktorin në këtë rast. Në rast se ka mirëkuptimin me shku me hjek atë, se është obligative, gjithëhere u hekë. Jakup, çështja e hartimit të projekteve 2021-2023-2024-2026, vlera prej 800 mijë euro, konsideroj e kemi pas informatën e Zyrës së Prokurimit, ke mujtë në atë kohë me bë, tash për detaje duhet të përgatitem për seancën e ardhshme, se kjo kërkon një detajizim. Nuk dua të flas me hamendje, se ti ke kërku diçka detaje çka është. Nexhat, kemi pas takime edhe me "Hidromoravën", e kanë marrë edhe ata përsipër, se te çështja elektrike na ka ndihmu diçka. Unë këto ditë e kam pas një mungesë pak në punë, dhe me sa jam në dijeni, është në përfundim projekti, ju ka dorëzu Zyrës së Prokurimit. Tash sa na kanë lanë parë, për shkak të kontratës kolektive, nuk e di, se më duket se është e përgatitun projekti, dhe pritët me dalë për 5 fshatra për eliminimin e defekteve. Te ndërtimi i trotuareve, tregova se është fjala gjithëhere këtu. Kanë bë pyetje, gjithëhere ka qenë mungesa e mjeteve të cilët po bëhet viti i 3-të që po ballafaqohemi me atë që po na e marrin, se ata të pyesin, në rast se nuk jep përgjigje, i mëshojnë atje ku të gjejnë të lira. Asfaltimi i rrugës Viti-Sllatinë, është intervenu 28 vende, unë kujtoj dhe nuk e ndryshoj atë konceptin tim se, kjo është në nivel Kosovës, po ndodhë e kam thanë dhe në kuvendin e kalum, e di që nuk ju ka pëlqy, që e kam bë atë krahasim, te unë po mbizotëron bindja, ndoshta mos profesionalizmi i prodhimit të asfaltit, ndoshta e kam gabim, nuk po të themë që merre, kështu të ka ndodh në Viti, ka ndodh dhe në vende tjera në Gjilan-Klllokot-Pozheran. Tu ka bë e njëjta. Këtu diçka është tu ndodhë. A nuk kemi profesionalizëm për atë punë a çka është tu ndodhë veç diçka në Kosovë, nuk është si fenomen veç në Viti, por në pjesën dërmuese. Bile kjo rruga Viti-Sllatinë ka qenë e shtruar për herë të parë. Kjo mund të ndodhë dhe ngjeshja mos me qenë në nivelin më të lartë, e krejt ato, dhe kur e krahason me të tjera, është shumë më mirë, jo shumë i knaqt. As unë personalisht, pikërisht dhe për atë nuk u bë pranimi teknik. Atë që the me pas ndriqim publik, unë e kuptova si provokim, e shenja e komunakacionit duhet urgjentisht, jam për mu bë dhe do ta shikojmë mundësinë a e ka pas në këtë pjesën që nuk e ka pranë teknikisht me ekzekutu. Këtë do të shikoj, po megjithë atë shenjat e komunikacionit duhet me ekzist. Kontrata për shërbimet me "Kosova Med", unë konsideroj se është kanë përmes Zyrës së Prokurimit. Ka plane familjare të drejtorëve, unë besoj se këto janë motive të ulëta, por megjithatë ti këshilltar i parashef, ashtu i ke thanë. Shqetësime në rrugën "Agim Ramadani", pengesa. Nuk e kuptova çfarë pengesa ka, a e ke fjalën për ngushticë ajo. Ka ekzistë gjithashtu, por a ka qitë dikush pengesa në trotuar.

z.Musli Neziri: Aty është duke u punu, dilni shikone, edhe pasi është bërë trotuari, është i gjanë, është pengë, është mshel krejt. Ka vende ku kalimtar dalin në rrugë krejt.

z.Xhelal Musa, inxhinier: Aty është punu vjet. Ajo rrugë është i parapam dhe trotuari një pjesë ka qenë e ngushtime. Ajo pjesë që është ngusht është e 2 pronareve serb. Unë prej vitit '88 në viti jetoj dhe e di atë vend shumë mirë, aty është pronë private, që nuk u leju me intervenu. Kemi insistu me marrë atë me privatizu, por

nuk na kanë leju një pjesë tjetër është afër rrugës përball çerdhes pak më poshtë, aty është një pronar serb, ai me vetkontribut e ka lëshu 1 meter e gjysmë ka hy më brenda, dhe ai ka qenë pronë e tij. Dhe tjetri serb nuk ka leju me lëshu. Në pjesët ku nuk ka pas mirëkuptim, nuk kemi mujtë me zgjeru.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: E ke shtrur një çështje me të cilën pajtohem, por megjithatë kisha me ju bashkëngjijtë edhe disa tjerë. Rruga Gjilan-Ferizaj, te qeshmja e Budrikës është më katastrof, nuk është as e asfaltume, vazhdojmë te rruga e Skiferajt. Te rruga e Devajës, krejt rrugët nuk janë vetëm këtu, por ka është ndërtu rruga Gjilan-Ferizaj e kanë lanë në atë gjendje. Unë e di se ata janë kanë kompetent, dhe në momentin kur e bënë atë rrugë, me bë edhe qasjen e këtyre rrugëve, me përshtat. Nuk e kanë bërë. Në rast se nuk e kanë bërë, duhet me shiku mundësinë me intervenu në bazë të mundësive, mjeteve të cilat i kemi, se jo veç një. Kjo më ka ra në sy. Si të fillojsh, krejtve. Sokol, ndjej shumë keqardhje për rastin që ka ndodhë. I bashkëngjitem asaj të cilën e shtrove ti dhe kryesuesi i kuvendit, që organet e drejtësisë ta bëjnë zbulimin e rastit sa më parë, jo për shkak personalitetit tanë, por gjithëherë një bjenë dhe duhet zbulimi, për shkak se ruhen të tjerët. Unë krejt që mujë në KKSB do ta ngriti këtë çështje, do ta pyes kapitenin e policisë, se merrë pjesë aty, dhe to të kërkoj me këmbëgulje që kjo çështje të hetohet dhe zbulohet sa më parë. Një e di se, jeta e njeriut është e shenjt, por edhe pasurai është e shenjt. Taulant, i urove drejtorit të ri, edhe unë i uroj, nuk ka qenë kjo e fshehur, por është në domenin e kryetarit, ka kërku drejtorin për me liru, për shkak gjendjes së tij familjare, tash e tutje kemi një drejtor të ri të cilit i urojmë shëndet, dhe drejtorin të cilin e kemi liru, ishalla sa më shpejt ai djalë e merrë jetën e normalitetit. Për ndërtesat, unë e di që prej drejtorit e ke informacionin që, keni kërku sot, e ke në rend të ditës dhe do të njoftohesh dhe sa detajisht, sa kanë leje dhe sa nuk kanë leje. Mos prezenca e kryetarit, e shtroi një këshilltare. Kryetari do të jetë, jo që i ka ik, mos u bëjë marak, por ka probleme të veta shëndetësore të karakterit oral, se ai së shpejti do të jetë së bashku me juve dhe neve. Mungesa e një barnatore kujdestare. Kuvendi komunal, është e vërtet që mund të bjen vendime dhe të cakton, por megjithatë duhet ta kuptojmë se janë kompani private, dhe në rast se nuk ka interes, nuk e mbanë ai gjithë natën qelë me pagu ai një punëtor. Unë e di se në Gilan bajnë gara, cili me kujdestaru, se është spitali regjional. Edhe në Ferizaj, edhe në Prishtinë, por nuk bajnë edhe në Viti, që i shet brenda natës 5 euro, e që shpenzimet për punëtorë, e për rrymë, e për sende i kushtojnë 50 e 100 euro. Raportin nuk na e keni pru ne me kryesuesin rregullisht i kemi tregu. E di, për 1 muaj a 2, me lejen e kryesuesit është kërku me u shty, ndërsa sot e keni. Ti sot po thu ndoshta nuk ju ka konvenu. Jo be na ka konvenu, qe ku e ke, tashti e kemi pa të gjithë çështjen e raportit për punët të cilat janë pranë teknikisht dhe nuk janë pranë. Në informatë e ke. Këshillat e fshatarve, mospërfillje i keni marrë veç 13 kërkesa të tyre. Unë qëndroj sërish pranë asaj të cilën e themë vazhdimisht, çdo kryetar komune i cili fiton, e ka një program me të cilin kanë dalë dhe qytetarët i kanë besu, dhe prioritet mbi prioritet është realizmi i programit të vetë, me të cilët qytetarët ja kanë dhanë besimin, dhe në kuadër të asaj, kryetari jonë i ka marrë dhe 13 kërkesa tjera. Ka pas mundësi, por megjithatë prioritet i prioritetëve është realizmi i programit, me të cilin qytetarët e komunës i kanë besu për qeverisje 4-vjeçare. Zgjidhja e këshillave të fshatit. Unë e di që i ka kalu afati, ndoshta mu me më pyet profesionalisht, ndesh i himë procedurës me i zgjedhë, por ndoshta në këtë vit zgjedhor nuk i kisha ngucë hiç, kur e kanë vazhdu deri tash. Qeveria e re që formohet, zgjedhjet e reja i hinë dhe e kryen atë çështje. Kërkesa e familjeve të dëshmorëve për varreza. Majlindë, ti e din një, 3 ditë kam qenë me ty me një punëtor të punës, dhe nuk e pasna pa. E kam parë një kërkesë dje të invalidëve të luftës së UÇK-së, pensionistëve të cilët ja u kam nda me një vendim një zyre për funksionalizimin, ndërsa këtë nuk e pasna pa. Ndoshta edhe kjo është, do ta shikojm mundësinë çka kemi mundësi me bë. Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës janë ka punojnë dhe konsideroj është në përfundim me 16.12.2024. Ndoshta e ke pas fjalën, ke thanë një kërkesë nga ofiqaria. Kurrë, me përgjegjësi të plotë po të themë, asnjë formular të asnjë punëtor të pranuar dhe të shkuar në pension kurr nuk e përgatit kryetari. Gjithherë dihet cilat zyre i përgatisin, i bjen kryetari ashtu, dhe në asnjë pagë të cilët janë momentalisht me përgjegjësi të plotë po e themë, kabineti i kryeatrit nuk është përzi kurrë, ata e kanë nga një përshkrim të vendeve të punës, të cilët nga përshkrimi i vendeve të punës ju kanë shku atje. Ka pas lëshime, gabime, ka mujtë, unë konsideroj që Zyra e Personelit në kohë, menaxheri i personelit i ka nejt asaj çështje dhe i vjen momenti dhe ato çështje rregullohet, nuk është tu e përdor Sokol Haliti për me i rritë poenat as me zbrit.

Gabim e ke thanë. Ne i kemi pranë, ka qenë shefi i ofiqarisë një personalitet i respektum, nga ana jonë e kemi pranë në takim dhe kemi thanë, kemi me shikë këtë çështje me rregull. Deponitë ilegale. Ali, janë ka i evidentojnë, janë ka i eliminonë çka janë tu mujtë, megjithatë duhet. A e kemi të kështj një çështje? Plani zhvillimor komunal i kaluar, por pa dashtë me e kontestu se ata e kanë bënë njerëz profesional, e kanë bënë atë vendin në Devajë dhe një ka Sllatina. Na u ka dokë jo adekuat, kemi intervenë dhe ne kemi ndalë atë çështje. E di që drejtori ka pas të Agjencionit Pyjor dhe me të kryetarit me bisedë për çështjen te gropa në Radivojc, që është shumë i përshtatshëm. Në krahasim me të kemi me eliminë atë dhe me ja kthë normalitetin, se ajo pasqyrë e keqe është. E di që me planin zhvillimor komunal të rivin ishin caktë në 3 lokacione, atë lokacion kemi me gjetë së bashku me juve dhe me i caktë vendet ku janë më të përshtatshëm me i hudhë. Faleminderit!

z.Musli Neziri: Po ndërldhem me përgjigjen e z.Xhelalit. Ju thatë se prej 88-ës jeton në Viti, por aty përveç pronave serbe që e tregove atë, ne jemi kogjo moti tu e frekuentu atë rrugë. Aty nxënësit që çdo ditë ballafaqohemi me mbyllje, tanimë nuk po flas përveç asaj që ka qenë ngushticë, por tash nëse qohemi prej këtu e shikojmë aty, trotuari është i mbyllt komplet, për shkak një punimi që është tu bënë. Tjetra, është pengesa te "Metaliku-S". A keni tentu me bënë një zgjidhje, se aty është paleta në rrugë, dhe aty 20cm ka trotuar. Po ndërldhem me përgjigjen e nënkryetarit. Nënkryetar, këto pengesa që kanë ndiku nëpër fshatra të rrugëve, kyqjeve që kanë aty, përveç asaj që është, është e vërtet që kemi pa të gjithë, por ndoshta në komplet vitin na kanë lanë qorr aty. Tani që me të vërtet kërkoj që me bënë zgjidhje, që komuna me kontakt ministrit, kush e ka pas tenderin, që me bënë zgjidhje edhe për fshatra, por edhe për komuna, ndërsa për kontratën për shërbime me kopaninë "Kosova Med", ato që i thashë, qëndroj prapë prapa saj, dhe është e vërtet që është bënë përmes prokurimit, kontrata është nënshkru, por pse me u shfrytëzë ajo që kryetari i komunës, që ja kontratën. Ju e dini, edhe për sqarim që, të jemi sa më të sinqert për opinionin, vetëm lista të bëhet publike dhe e mbyllim këtë debat. Nuk kemi nevojë me akuzu askënd njëri tjetrin.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nuk do të themë që ka me mujtë me bënë mrekulli, do të interesohem maksimalisht kush e ka pas tenderin, në rrugë e kam fjalën, dhe ka me kërku me i kriju qasje të gjitha rrugëve që dalin në rrugën magjistrale.

znj.Majlinda Shabani: Nënkryetar, tek mos prezencë e kryetarit në seancat e kuvendit komunal, prej mandatit që ka fillu kryetari ka qenë prezent vetëm kur është sjell informata. Edhe tek kjo informata e fundit nuk ka qenë fare në kuvend edhe kur është votu buxheti. Atëherë këto arsyttime nuk qëndrojnë fare. Nëse është mungesë e guximit me ardhë mu ballafaqu në kuvend komunal për çështjet që ne i adresojmë është diçka tjetër, po ai duhet me ardhë, se tek e fundit nuk kanë met shumë bre, edhe gjashtë muaj le të vjen në kuvend. E për arsyetimin që dhavë, për mungesë të shërbimit në barnatore, unë po e kuptoj që është tendencë e jote, edhe në këtë rast e ekzekutivit me e hedhë fajin edhe me largu përgjegjësinë prej vete. Tashë në secilën komunë këto barnatore janë private, e juve si ekzekutiv, si kryetar i komunës, që nuk don fare me u marr me këtë problem, që qytetarët e komunës e kanë, edhe na krejt këto po muj me e kuptu pozicionin që i pari i komunës, dhe nënkryetari, edhe drejtoresha e cila është. Llogaritne, kryetari i komunës i merr i emëron krejt drejtorat, nuk i le asnjë mundësi me i zhvillu politika, qoftë mendimet që i kanë. Komplet vendimet merren nga ana e tij. Unë megjithë konsideratën, nëse kisha qenë me një pozicion të tillë, unë nuk kisha mujt me qëndru aty ku fjala ime nuk ish ndëgjju, edhe me marr me me vendos mu si emër e si numër, edhe si plotësim kuote. Unë këtë gjë nuk e kisha toleru, po këtu e shofim si interesi i të parit të komunës nuk është për mu zgjidh ky problem, sepse përderisa kryetari i komunës lidhë shërbime profesionale në vlerë 1 milion e gjysmë, edhe kur i merr qeto shërbime, tani llogaritne shërbime janë hi në kategorinë e investimeve kapitale, e në fakt nuk janë fare investime kapitale. Tash këtu ne mundemi me e kuptu edhe mendësinë e qeverisë që e ka kryetari i komunës. Paramendoni çfarë mekanizmi të qeverisë ka ba me i marr komplet me i shtrë kontrollin në persona të cilët i duhen për kohë fushate dhe për vota. Nuk ka investim kapital këtu në shërbime profesionale, që ju i bani një milion e gjysmë. Na krejt e dimë, këtu nuk ka investime kapitale, këto janë për interesa të caktuara me u punësu bashkëpartiak të tijë, njerëz familjar dhe njerëz që ju konvenon. Kjo është praktika e kësaj qeverisje. Se tash vjen koha e zgjedhjeve, jemi tu fol për këto kontrata, për këto miliona që ju jepni dhe kurrë nuk sjellni informacione, se ku i jepni këto

miliona. Publikone listën t'i shohim njerëzit ku i keni punësu, merrne zgjidhne problemin e barnatorëve, e barnatarëve që qytetarët e komunës e kanë, se hajgare me jetë të njerëzve, nuk ka as me jetën e qytetarëve, përderisa krejt komunat në Republikën e Kosovës e kanë pru mase me rregullu këtë çështje si kryetar, si nënkryetar, dil thuj përpara se edhe ne kemi me rregullu, ose dil thuj më fal, por nuk na konvenon. Kryetarin nuk pe kemi prezent, të paktën nënkryetari qenka këtu, një seancë e kemi krejt muajin. Lem t'i sqaroj çështjet të cilat nënkryetari tha, te kërkesat e administratoreve që tha nënkryetari, kryetari i komunës ka një program qeverisës. Nuk e di a ndëgjut krejt a veç unë e dëgjova, tha nuk i ka marrë me i përfshi kërkesat që i kanë bërë administratorët, tha se ka qenë i fokusum me plotësu programin qeverisës të tijë. Paramendoje çfarë programi qeverisës të tijë, i cili në mandatin e parë të tijë ka premtu që ka me u zgjidhë çështja e ujit të pijshëm, e është mandati i 3-të i qeverisë së tijë dhe ende po donë me na mashtru neve që është ka donë me realizu programin qeverisës të tijë. Ta kish plotësu perime programin qeverisës dhe premtimet që i ka bërë në kohë fushate, kishte me qenë shumë në rregull, ama jo, se këtu milionat kanë shku veç në asfaltim, se këtu ka qenë interes i investitorëve. Unë nuk e di si komuna a keni ndonjë ide apo politikë, diçka që e bënë ndonjë zhvillim të mirëfillit të Komunës së Vitisë apo veç asfaltim, beton. Çdo kohë kemi kritiku, dhe bile nganjëhere jemi bërë të tepërt tu e diskutu këtë çështje.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Unë nuk terhekem prej asaj të cilën e themë. E nderuar këshilltare ka program të cilën ti se ke votu, por ata e kanë votu 3 here. 3 here e kanë votu, 3 herë rradhazi programin e kryetarit Haliti dhe është në realizim. Mos me qenë në realizim nuk i kishin dhanë. Këto fjalët e tij nuk nxajnë vend, 3 herë ai ka dalë me program para qytetarëve të Komunës së Vitisë 3 herë i ka fitu zgjidhjet, është e vertet, vjen edhe për herë të 4-ër del me program, njerëzit kanë me kqyrë a e ka realizu apo jo. Matësi më i mirë është qytetari.

z.Nexhat Halili: Nënkryetar, unë ju kuptoj se shpenzimet e vendimeve gjyqësore me të vërtet janë të larta, por se dhavë arsytimin për trotuar dhe investimet kapitale, mirëpo unë nuk muj me ju kuptu kur kontrata prej 27.10.2021 deri me 27.10.2023 nuk ka përfund, as nuk është bërë pranimi teknik. Leje që nuk është bërë pranimi teknik, por nuk është përfund. Ju lidhni kontratën e re, ju keni lidhë kontratën e re me 08.08.2024 në velrën 1 milion 158 mijë e 764.53 euro. Ku po i gjani këto pare tjera nëse nuk keni pas pare për ato, atë projektin e mëhershëm? Ka i keni marrë paret për këtë projektin tjetër nëse nuk e keni përfundu projektin e parë? Qysh po filloni me projektin e dytë? Tjetra. Në muajin e kalum kam bërë pyetje për rrugën "Agim Ramadani", për projektin e rrugës, ku te puna shtesë, brendësia del krejt rrugë tjetër. Përgjigje nuk morra, nuk më ke pru, se e kam ditë që atë ditë nuk mundesh me më dhanë përgjigje, por e kam pritë për këtë seancë. Brendësia e rrugës, del Xhemajl Ademi, merrne analize, unë prapë të kuptoj që nuk mundesh me dhanë përgjigje. Hartimi i projekteve është tu bërë shkel e shko ose ajo kompania e cila e bënë hartimin e projekteve nuk është profesionale, se me tu paraqitë poroblem në fillim, kjo është e patolerushme.

z.Illir Zuka: Deshta me u ndërlidh me asamblisten Zyrafeten, për shkak që ajo është tu e bartë atë problemin që e kemi në shkollë. Liridonë, nuk më përket me sha, përndryshe Nexhatin e kam dajë, nuk shajta, absolut jo.

znj.Liridona Bislimi: Te dy çështjet që i diskutum, drejtor, e di që edhe përmes telefonatës e kemi diskutu këtë çështje. Tash nuk e di për juve a është njëfar bonusi që po e përdorni këtë mandatin e fundit, këto investime që po janë përmes qeverisë, tash mos të themë që po thuni shqyr që po janë prej atjehit, dhe automatikisht bartja, përgjegjësia po kalon me një kompetencë tjetër, dhe ditën e mirë. Kjo problematikë, e dimë që kjo rrugicë, qato kodra që janë në atë pjesë janë vazhdimisht prej që unë ekzistoj, e di që është kjo problematikt. Unë dua me kërku prej juve që me marrë me konkretisht, jo me thënë që është kompetencë e ministrisë, se ndoshta ministra atje nuk mund me ditë që një fshat i vendit rural i Komunës së Vitisë ka problematika. Nënkryetari në mes të përgjigjes e tha që ka pas lëshime dhe gabime. Fatkeqësisht ky nuk po e kupton që, ky lëshim i institucioneve, ky gabim ju ka kushtu 50 personave, 50 familjeve për 1 vitë në pagë minus 150 euro. Tash mua më intereson me ditë, a ka me ja u kthy këto pagesa. Se i bjen deri tash ata janë afër 2 mijë euro humbje. Tash nuk mund me thanë kemi bërë një lëshim, por në rregull se ndoshta kemi me përmirësu, e kjo është një vazhdimsi e sipër. Po flasim për 1 vitë që ju po e pranoni që keni bërë një lëshim në gabim, por tash nuk po e di, kjo çështje që ka me u rregullu: a kanë me u kompenzu me këtë dëm që i takon institucionit komunal? Për shkak që e përmenda, nëse i kish pas

diçka niveli nacional, unë e di se si kish reagu nënkryetari. Unë e di si e kish pas qasjen e tij, nuk e kish kalu kaq lehtë përgjigjen, e mos të flasim për të parin e Komunës së Vitisë, se çfarë aktivitete politike kish mujtë me shfrytëzu këtë, dhe thotë nënkryetari se na e dimë me listën e pagave të mësimdhënësve, se çka ka ndodhë. Jemi bërë shembulli më i keq në nivelin nacional, se si një kryetar e ka shfrytëzu. A ka me u krye kjo pagesë dhe deri kur ka me zgjatë? Se njerëzit po dojnë me ditë a me shku me punë me pagë minus a me ndal punën.

z.Basri Aliu, drejtori: Më duket nuk po i dini kompetencat, se cilat janë komunale dhe qeveritare. Ne nuk kemi të drejtë me ndërhy me investime në rrugë, të cilat janë pronë e dikujt tjetër, pa pas leje atje. A mund, po ndërhy sikur që thashë është pronë e Agjensionit të Pyltarisë grope atje, po duhet me kërku leje, apo më lejon apo jo. D.m.th edhe rrugët janë pronë e Ministrisë së Infrastrukturës. Ne kemi ngritë shqetësimin, kemi thanë se duhet të interevenohet, dhe tani është çështje e tyre, ose ne duhet me bë një kërkesë, me thanë a po na jepni leje. Por, pse ne me marrë atë përgjegjësinë e tyre, kur ata kanë mundësi dhe mjete të mjaftueshme, ashtu si po thua ti, që është në territor të Vitisë, atëherë ne duhet me ndërhy nëpër të gjitha rrugët që janë në rrugën Ferizja-Gjilan etj. Për punën e pagave. Ata kompenzohen në qoftë se janë dëmtu, përmes gjykatës. Edhe ato që i përmendi, rrogat e ulta. I ka vendos dikush tjetër. Edhe për arsimtar e për tjerë, që a ju dalin a nuk ju dalin, është vendim i dikujt tjetër.

z.Bekim Azizi, kryesues: Procedura më e mirë është që e kanë bërë mësimdhënësit. Momentin që nuk e merrë pagën të mjaftueshme ose ju ka bë një shkëlqje, vazhdoni procedoni në gjykatë i merrë me kompenzim. Nëse shërbyesit publik nuk e kanë koeficientin e duhur në bazë të Ligjit të Pagave, atëherë ata nëse nuk ju hahet, zgjidhja në mënyrë retroaktive, duhet të ju drejtohen gjykatës, dhe nëse ka të drejtë e merrë kompenzimin në bazë të gjykatës. Faleminderit për kontributin! Materialin e keni marrë me kohë, për këtë seancë kemi parapa këtë rend të ditës:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillugut, Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Hanit të Elezit, Shtërpçës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetjen financiare në shumën prej 3500 euro për Sindikatën e të Punësuarve në Shërbimit Civil (SPAK) në Komunën e Vitisë.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e luajtshme, e cila evidentohet në pronësi të Xhavit (Januz) Bajramit.
6. Informatë mbi kontratat e papërfunduara në tri vitet e fundit 2022-2024.
7. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit për lejet ndërtimore gjatë viteve 2021-2025.

z.Bekim Azizi, kryesuesi: Hapi debatin për renditë e ditës.

znj.Majlinda Shabani: Po e marrë fjalën në emër të shefit të grupit. E para, tek materiali që e keni sjellë dhe na e keni dërgu në e-maila, tek pika që kemi diskutu, kontrata të cilat janë të nënshkrume për periudhën 2022-2024, kemi probleme aty, nuk shihet se çka figuron te pjesa e arsytimit, është komplet pjesa e trumbullt dhe e kemi pas në diskutim në KPF, ku kemi kërku që ai dokument me u rregullu. Materialin e kemi sjellë, nuk kemi mujtë kurgja si asamblist me i analizu në bazë të dokumenteve që ju i keni sjellë. Edhe tjetra, tek kërkesa e sindikatës që e kanë përcjell si kërkesë e grupit tonë, po besoj që e kishim diskutu edhe kur i kish ardh rendi, mirëpo kërkesa jonë është që më së pari të merret interpretimi ligjor prej MAPL-së. Në momentin që MAPL e kthen që është e ligjshme, atëherë me u sjellë në kuvend me u diskutu si pikë, dhe mandej me votu. Nuk po dojmë me ardhë në pozicion me i mashtu shërbyesit, se kemi pas rast ku kemi pru vendime siç i kemi pas për shujta, ku e kemi kalu në kuvendin komunal, mirëpo është kthi e kundërligjshme, edhe përderisa po kërkohet

për një maaj, po besoj që nuk mundet me ekzekutu se tash një maji vetëm ka ardh, duhet me u plotësu 15 ditëshin me shku në MAPL dhe mandje mu miratu, kështu që unë kërkoj se absolut nuk jam kundër çfarë do lloj kërkesë, që secili shërbyes civil e bjen në kuvend komunal. Natyrisht që jam për me i shpërbly për të gjitha kërkesat që ata i kanë në kudër të punëve që i bëjnë dhe shërbimin që ja japin qytetarëve, mirëpo së pari kërkoj që me u marr interpretimi ligjor, mandej me e sjellë në kuvendin komunal që me e pa na që jemi tu votu diçka që është e ligjshme, që është në përputhje me ligjin.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Unë tek pika e parë që fole, materiali që nuk është i lexueshëm, aty pate vërejtje, që edhe unë pajtohem që është i dobët, ndërsa tek pjesa e pikës që e bisedove, MAPL e përcjell tek ministria e linjës vendimin. Nuk përcakton ajo a është e ligjshme a po jo, duhet Ministria e Financave me bë konfirmimin e ligjshmërisë. Ne zakonisht e miratojmë vendimin, e dërgojmë në ministri, tani ata bëjnë konfirmimin e ligjshmërisë, unë e qoj vendimin e kuvendit që e miraton.

znj.Majlinda Shabani: Ne kemi pas edhe me herët kërkesë. Ju kujtohet për faljen e borgjeve, e keni qenë pikërisht ju kryesues e këshilltarë që më së pari keni kërku me pa a ka qenë e ligjshme qajo, madje me e pru në kuvend, që me e miratu. Ideja jonë është që nuk po du me i mashtru këta shërbyesit civil, që ne me e votu, vendimi i cili në fund kthehet i kundërligjshëm dhe nuk kalon. Unë kam kërkesë me u terjek nga rendi i ditës, me u marr interpretimi ligjor, madje me u sjellë në kuvend.

z.Illir Zuka: Unë para vete e kam një vendim që e ka nxjerrë Kuvendi i Mitrovicës, që ju ka nda mjete kërkesës së sindikates.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përveç pikave që i keni marr të rendit të ditës, në KPF i kam shtrur edhe tri kërkesa që kanë qenë. Faleminderit prej anëtarëve të KPF-së që kanë thanë naj sjellë propozimet në kuvend, ku KEDS-i ka kërku dy prona me ja dhanë në shfrytëzim për ngritjen e trafave. Është një vend në Viti dhe një në Drobesh. Prandaj, me lejen e anëtarëve të KPF-së ju propozoj këtë pikë të rendit të ditës. Dhe nën dy, kemi sjellë një propozim vendim për shpalljen në interes publik. Është fjala për një rrugë të cilën e kërkojnë me e ligj, nga lumi “Morava” me dal në qendër këtu. Kësaj kërkesë i kanë parapri edhe nënshkrimet e disa banorëve, që kërkesën e keni të bashkangjitur me propozim vendim. Dhe propozoj që këto dy pika të hinë në rend dite.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: Në KPF nuk kemi votu asnjë pikë jashtë pikave që ju ka ardh materiali. Me mirëkuptim kemi diskutu me ardhë pika e rendit të ditës për trafot, sepse nuk ka qenë materiali gati dhe kemi thanë që është urgjente. Le të vjen pika tjetër që erdh sot, ka ardh propozim që e propozoj nënkryetari.

znj.Majlinda Shabani: Në KPF kemi thanë, masi propozimi i KEDS-it është me urgjencë, po jemi me ardh në kuvend, po ne kemi thanë që prej fillimit, kjo praktikë e sjelljes së pikave direkt në kuvend është praktikë e keqe, sepse edhe pikat që janë në rend dite, janë pika shumë të rëndësishme që duhet me diskutu.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi: A ka dikush tjetër për me diskutu për rendin e ditës?

z.Musli Neziri: Kërkesa e KEDS-it është vonuar, kështu që ne duhet sa më parë me e miratu këtë kërkesë, sepse ajo zonë kanë problem me energji elektrike, prandaj kërkoj që të hin në rend dite kjo pikë dhe të votohet.

z.Ali Bajrami: Sa po e kuptoj unë, në KPF paska qenë pajtueshmëria që, kërkesa e KEDS-it me ardh në kuvend dhe mu votu. Për pikën tjetër mundësisht me naj dhanë një shpjegim sa është ajo rrugë, ku del ajo rrugë, ku është ajo rrugë. Nuk jemi me qenë pengesë, ama duhet me ditë se për çka po votojmë.

z.Basri Aliu, drejtor: Ali, rruga bëhet fjalë prej “Vives” që është mu lidhë me sheshin në qendër.

z.Nexhat Halili: Drejtor, ti përgjigjen e dhavë, po bile së paku me na tregu ku, sa metra gjatësi, sa metra gjërësi, prej ku fillon, kush ose çfarë procedure të prokurimit udhëheqen. Na shpjego pak më gjerësisht, ose me naj pru një material që të jemi të informuar, ta dimë se çka po votojmë.

z.Basri Aliu, drejtor: Materialin sigurisht e keni, jav sjellin fletën poseduese edhe kopjen e planit, që tani ju shperndat, sekretaria. Aty ceken te gjitha. Edhe në kërkesën e qytetarëve është prej rrugës së UÇK-së në rrugën “Adem Jashari”, tani sheshi “Nijazi Azemi”.

z.Nexhat Halili: Kjo prona, a është pronë shoqërore apo pronë private.

z.Basri Aliu, drejtor: Kjo prona që shpallet zonë me interes, është pronë private.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi: A ka dikush tjetër për me diskutu për rendit e ditës, pasi që nuk ka për me diskutu, me se pari qes propozimin a jeni që të largohet nga rendi i ditës propozimi i Majlindes, për propozim vendimin e sindikatës. Kush është për? Nuk ka asnjë kundër. Kush është që të largohet? Asnjë kundër, me një abstenim. Pika që u kërku nga Majlinda nuk heket nga rendi i ditës. Kush është që në rend dite të hin pika e rendit të ditës, propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës kompanisë kosovare KEDS për vendosjen e trafos elektrike. Kush është që kjo pikë të hin në rend dite? Me votat e të gjithëve, kjo pikë hin në rend dite. Nuk ka as kundër as abstenim.

znj.Majlinda Shabani: Kryesues, a ka mundësi, se po ndërlihem me kolegen. Prej fillimi të votimit kur hape për me e votu, këta që votun kundër, a ka mundësi mu përsërit edhe njëhere, se po me doket jemi tu shku pak si llug e nuk po di se kush qysh po voton. Unë kërkoj që edhe një here mu përsërit votimi, ose e du një pauzë 5 minuta, ne grupi.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi: Ende nuk u miratu rendi i ditës. Majlindë, nuk jemi tu bë hajgare. Unë e qita në votim. Pse nuk ndëgjoni ti, nuk të ka faj askush. Krejt votun për, ti abstenove. Tash jemi tek pika që e kërkuan për rrugë, nëse do 5 minuta, që ki mu konsultu për qet pikë, marrim pauzë.

z.Basri Sylejmani: Unë nuk jam për me e votu qeta, nuk jam tu e ditë se çka jemi tu votu, nuk po e dimë ku del kjo rrugë, nuk e di unë, interesat.

znj.Majlinda Shabani: E patëm konsultimin ne si grup rreth propozim vendimit për shpallejn zonë me interes të përgjithshëm publik. Ne kërkojmë që kjo pikë me u shty, sepse ka shumë paqartësi, me gjithë konsideratën e banorëve.

z.Ali Bajrami: Edhe ne kërkojmë sqarime shtesë, edhe ne jemi të mendimit që mu shty e mos me votu diçka që nuk e kemi të kuart.

z.Musli Neziri: Edhe ne kërkojmë që mu shty kjo pikë, dhe pas hartave zonale le të vjen kjo pikë e shiqojmë tani.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Me të vërtet unë nuk du me ju qitë edhe juve në pozicion të palakmueshëm, ama në rast se me plan zhvillimor komunal është e parapam, dhe ju e keni votu planin zhvillimor komunal, e shohë një mos përputhje të mendimit të juaj. Ju për mu shtyne dhe kurrë mos e apromoni, po megjithë, në rast edhe unë sipas informacioneve që kam, kjo rrugë është në plan zhvillimor komunal që e keni aprovu ju dhe hartat zonale hartohen mbi qat plan.

z.Basri Sylejmani: Unë jam kundër, sepse nuk jam tu e ditë se ku po del kjo rrugë, duhet me ditë.

z.Taulant Haxhiu: Ndëgjoni, nëse është te "Rio", aty janë dy banesa, dy blloka janë në qendër të qytetit, ne duhet me ja dhanë një dalje qytetarëve dhe banuesve që janë mbrapa atyre banesave që jetojnë qytetarët aty. Aty janë dy ndërtesa e ti po don me i ngulfat. Boll i ka ngulfat komuna qytetarët e Komunës së Vitisë me këtë shesh. Nuk po kanë ka me hi me dal, tash ata duhet me pas një dalje në shesh, ajo është qendër, ai po kërkon me e ndërru atë pronë.

z.Ramadan Deliu: Unë kërkoj me thirr njerin kompetent, me na njoftu sakt se ku është ajo rrugë.

z.Ilir Zuka: Kryesues, unë po mendoj që me shti si pikë të rendit të ditës deri sa të vijnë ingjinerat me na tregu sakt se ku ka me dalë rruga. Po besoj që Taulanti e shpjegoj mirë, janë tri objekte aty.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendi: Me kërkesën e të gjitha grupeve për shtyrje mos me hi në rend dite, kjo pikë nuk hinë në rend dite. Tash kërkoj miratimin e rendit të ditës me pikat që janë ardh dhe pika shtesë për KEDS-in. Kush është që të miratohet rendi i ditës? Me votat e të gjithëve miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e kuvendit komunal

z.Bekim Azizi, kryesues: Hapi debat. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet edhe kjo pikë? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2025

znj. Milihate Ajeti, drejtroeshë: Përshendetje për të gjithë të pranshit! Pasi që materialin e keni marrë me kohë, do të mundohem në pika të shkurtra t'i sqaroj pasqyrat financiare. Buxheti i aprovuar për vitin 2025 në total në kategori ekonomike është 18 milion e 53 mijë e 345 euro; buxheti i alokuar për periudhën janar mars 2025 është 6 milion e 801 mijë e 934 euro, ndërsa shpenzime për 3-mujorin e parë janë 6 milion 142 mijë e 723 euro; shpenzime për kategori paga dhe shtesa janë 2 milion e 499 mijë e 746 euro apo 99.46%; shpenzimet për kategorinë mallra dhe shërbime janë 79.67%; shpenzimet për shërbime komunale janë 85.62%; shërbime për subvencione dhe transfere janë 96.3%; shpenzime për investime kapitale janë 86.61%. Në pasqyrat financiare kemi të prentuar për buxhetimin e aprovuar, alokuar dhe shpenzuar në të gjitha programet buxhetore, Zyra e Kryetarit ka shpenzu 96%; administrata 90.24%; inspeksioni 95.60%; kuvendi komunal 95.93%; buxhet dhe financa kanë shpenzuar 86.84%; shërbime publike 95.18%; Zyra e Komuniteteve të shpenzuara kanë qenë 100%; bujqësi pylltari dhe zhvillim kanë shpenzuar 92.78%; gjeodezi, kadastër kanë shpenzuar 94.18%; planifikimi urban dhe mjedisi 22.67%; shërbimet sociale gjithsej kanë shpenzu 93.45%; kulturë, rini dhe sport 83.53%, arsim dhe shkencë 97.18%. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar-mars, të hyrat e planifikuara për vitin 2025 janë 1 milion e 270 mijë e 127 euro; të hyrat e planifikuara për periudhën e njëjtë janar-mars 370 mijë e 531.75 euro, të hyrat e realizuara për periudhën janar-mars 211 mijë e 270.39 euro; përqindja e realizimi, duke u bazuar në planifikimin 3-mujor është 66.52%; krahasimi i të hyrave vetanake në periudhën janar-mars, të hyrat janar-mars të vitit 2024; të hyrat për janar 2025 janë 3-mujorin 211 mijë e 217.39, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 204 mijë e 335.37; të hyrat e vitit 2025 janë më të larta për 6 mijë e 882.02 euro; prezantimi analitik i investimeve kapitale për periudhën janar-mars 2025, gjatë kësaj periudhe shpenzimet nga investimet kapitale në total janë 2 milion e 667 mijë e 672 euro që i keni të paraqitura në mënyrë të detajuar në raport. Vlenë të theksohet se, nga shuma 1 milion e 572 mijë e 766 janë të ekzekutara nga komuna, vlenë të theksohet se nga shuma janë vit për vit për projektet që kanë punë të kryera në teren dhe në situata të pranura nga organi mbikëqyrës, ndërsa shuma prej 1 milion e 94 mijë e 905 euro janë shpenzimet e ekzekutara nga thesari i shtetit, që këto shpenzime janë obligime të viteve të mëhershme, që rrjedhin nga kontrata kolektive. Në fund i keni të prentuara krahasimet e shpenzimeve për periudhën janar-mars në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Shpenzimet e vitit 2025 në krahasim me shpenzimet e vitit 2024 janë më të larta për 560 mijë e 427.66 euro.

z.Nexhat Halili: Pasqyrat financiare për buxhetin komunal për periudhën janar mars 2025. Gjatë periudhës janar-mars 2025, inkasimi i të hyrave vetanake janë 211 mijë e 217.39 euro, duke u bazuar në planifikim vjetor 16.63%. Krahasuar me vitin 2024 janar-mars, të hyrat janë më të larta për 6 mijë e 882.02 euro. Faqja 19, pika 2.1, tatimi në pronë dhe tokë. Më brengos fakti i mos realizimit të planit 3-mujor. Planifikimi 141 e 566.25 euro, ndërsa realizimi 103268.50. D.m.th mungesë ki 38 mijë e 886.15 euro. Pika 1.6, të hyrat tjera te ofiqaria janë të planifikume 17 mijë e 325, ndërsa janë të realizuara veç 5 mijë e 978 euro, 11 mijë e 347 euro janë minus. Pika 6.1 plani gjeodezik dhe kopje të planit janë të planifikume 7 mijë e 500, ndërsa janë të realizuara 1 mijë e 629 euro. 5 mijë e 871 euro i ke mungesë. Pika, leje ndërtimi, 22 mijë e 500 janë të planifikume, 1 mijë e 680.69 janë të realizume. 20 mijë e 819 janë mungesë. Taksa për legalizim të objekteve janë 38 mijë e 250 euro, ndërsa janë të realizuara veç 797 euro e 55 cent. 37 mijë e 452 janë mungesë. Në faqen 20, pika 11, të hyrat tjera, gjithmonë këtu jam dhënë vërejtje, mirëpo në këtë raport e keni rregullu, nuk jan as të planifikume si shpenzime të hyrat të tejra, as nuk jan të realizuara. D.m.th tash e keni rregullu këtë pikë. Shpenzimet buxhetore. Buxheti i alokuar janar-mars, 6 milion e 801 mijë e 934.35 euro, ndërsa shpenzime janë 6 milion e 147723.64. Shkalla e realizmit 90.31%, alokimi i pashpenzuar është 659 mijë e 210.71 euro. Pse ka ndodhë janë aloku mjetet, nuk jan zotu. Kur i ke pas mjetet, pse nuk janë zotu për inaksim kur i keni obligimet tjera. Shpenzimet e njërive buxhetore, drejtroeshë, të përgëzoj, te kodi buxhetor 1131, kontributi penzional punëtorëve dhe kontributi i punëdhënësit, tash i keni rregullu, se vitin e kaluar keni pas diferencë, mirëpo tani këtë 3-mujor e keni rregullu. Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale, kodi 13440 89 mijë e 50. Këto janë 30 mijë euro që janë të bartura nga viti i

kaluar shërbime profesionale për energji. Shërbimet e veçanta, konsulente dhe kontraktore individuale, vlera 4 mijë e 526 euro. Shërbime kontraktuese tjera, 13 mijë e 1 euro. Çka janë këtu? Është një obligim 1 mijë e 491.60 euro prej spitalit regjional të spitalit. Nëse këto janë obligime të vitit të kaluar, unë jam bazu në bazë të obligimeve të vitit të kaluar. Pasqyrën që e keni paraqitë vetë në ueb faqen e komunës. Pajisjet e trafikut. Unë e di që në kohën e fundit nuk ka pas kontratë për pajisje të trafikut. Kjo kontratë ka qenë e mëhershme. A janë shpenzime të bartura prej viteve të kaluar? Pajisjet tjera. Edhe këtu kemi obligime nga viti 2024, edhe te furnimizmet mjekësore “Biolab”. Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, 23 mijë e 549 euro ja keni borxh operatorit ekonomik. Një brengë që unë e hasa, shihen se të gjitha fakturat janë të muajit 11 dhe 12. Investimet kapitale të paraqitura në pasqyrat financiare kapin vlerën 2 milion e 667672.16 euro; kodi 300, investimet kapitale 1 milion e 572 mijë e 766.98; ndërsa kodi 34 mijë, pagesat sipas vendimeve gjyqësore 1 milion e 94 905.16. Përqindja e vendimeve gjyqësore në raport me investimet kapitale e ke 41.04%, ndërsa investimet kapitale të cilat i keni paraqitë në tabelën nr.23 dhe 24 është vlera 1 milion e 572 766.98. Në proporcion me investimet kapitale i ki 58.96%. Kur të hymë tash në analizë, prezantimi analitik i investimeve janar-mars 2025, pothuajse 90% e të gjitha këtyre projekte të cilat janë paraqitur në këtë listë janë shpenzime, nuk janë investime të 2025-ës, por janë investime të 2024-ës, që janë bartë në vitin 2025. Ke rastin, p.sh.: ndërtimi i kanalizimit në Komunën e Vitisë, asfaltimi i rrugës “Hoxhë Jonuzi” dhe “Muhamed Muharremi”. Kjo rrugë është me grand të përformancës. Kjo rrugë ka përfunduar me 31.12.2024, ndërsa ka obligime ende pa u pagu, përveç këtyre obligimeve që janë pagu, që janë bartë prej vitit të kaluar këtë vit. Ne e dimë që grand i përformancës nuk e di që bartet prej vitit të kaluar në vitin e ardhshëm, mirëpo ju këto shpenzime i keni kry. I njëjti rast është edhe me ndërtimin e sheshit në Viti, faza e dytë. Përveç fazës së dytë e keni edhe fazën e tretë, që fazën e tretë gati nuk keni ba asnjë pagesë. Është prej grandit të përformancës. Një pyetje e kam tek pozicioni i tetë, ndërtimi i palestrave sportive shkollore “Kuvendi i Lezhës”, Viti, dhe shkolla fillore Sllatinë e Epërme. Për mos me përmend furnitorin, edhe pse këtu janë të publikume “Euro Komerc”: a mundeni me ma ba dallimin në “Euro Komerc”, cilën palestër sportive e ka? Kontratën dhe këto obligime të cilat janë bart prej 2024 në 2025: a janë obligime vetëm te shkollës “Kuvendi i Lezhës” apo edhe të shkollës së Sllatines, të dëshmorit “Njazi Rexhepi”, për arsye se ju krejt këto shpenzime i keni paraqit në pozicione nr. 8, ndërtimi i palestrave sportive dhe shkollore “Kuvendi i Lezhës” dhe shkolla fillore në Sllatinë të Epërme. U kanë deshtë së paku bile me i nda, me ditë cilat, sepse nuk janë të njëjtët operator ekonomik të cilët e kanë kontratën. Tash e ki operatorin ekonomik “Euro Komerc”, që e ka shkollën e Sllatines, po “Kuvendin e Lezhës” e ka dikush tjetër. Tash në bazë të këtyre analizave që shihen, nuk dihet se cilët operator ju ka bërë pagesa, po shifet që ju ka bërë “Euro Komercit”. Po tash për cilën palestër është, për shkollë të Sllatines apo për “Kuvend të Lezhës”? Në bazë të kësaj që e keni paraqit ju vet, edhe pse unë di që se, i ki pasqyrën e obligimeve të vitin 2024, që janë bart në 2025, aty i keni të specifikuar tek pasqyrat e obligimeve që janë me emra të operatorëve ekonomik. Drejtoreshë, edhe në seancën e kaluar ta kam dhanë një porosi, me e bërë një ndryshim, se e ki një diferencë prej 11 mijë e disa euro, që faturat e specifikuar nuk përputhen me vlerën e pasqyrave financiare, të cilën e keni paraqit deri me datën 31.12.2024, ka dallime edhe me KAB. Obligimet e kompanive ose të qytetarëve që janë ndaj komunës, nuk i keni paraqit në pasqyrat financiare të viti të kaluar. E di që me ligj nuk lejohen emrat e qytetarëve mu paraqit, po së paku shumën e përgjithshme keni muj me paraqit, se sa janë obligimet e qytetarëve ndaj komunës, sepse i keni obligimet e qytetarëve me të mëdhaja se sa obligimet e komunës ndaj operatorëve ekonomik. Te numri 1, ndërtimi i kanalizimeve në Komunën e Vitisë: a mundeni qeta me shpjegu, cilët kanalizime janë rregullu në vitin 2025? Për arsye se, ky operator ekonomik që është lidhë, kontrata nuk shihet në këtë listë që e keni paraqit me emra të operatorëve ekonomik, që barten shpenzimet prej vitit 2024 në 2025, nuk e keni paraqit si obligim. A ju ka përvjel ndonjë gabim apo është punë që kryhen në 2025? Tek shpenzimet, investime kapitale të 2025-ës, mundet me dal një vlerë shumë e vogël, po janë shpenzime që janë bart prej 2024 në 2025.

znj.Mjalinda Shabani: Pajtohem plotësisht me çështje që i ngriti kolegu asamblist, sepse realisht unë pajtohem, edhe koha e raportimit që jemi tu e bërë nuk është koha reale, dhe është absurde me e kuptu faktin që, ekzekutimi i buxhetit bëhet dikun 100%, kur dikun 40% i ki vetëm vendime gjyqësore, dhe sidomos investimet

kapitale që janë tu figuru, që janë për qet tremujor, në fakt janë edhe investime që kanë qenë prej viteve të kaluar, që janë bart. Nuk është raportim real i shpenzimeve që bëhen për këtë periudhë tremujore, që ja jemi tu e fol, edhe gjithmonë kemi pas kritika të vazhdueshme në këtë çështje, mirëpo ajo që sot unë po dua me diskutu është kodi 13440, shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Vetëm këtë 3-mujor janë diku 89 mijë e 50 euro. Nëse e merrë me pa vlerën në 3-mujorin e vitit paraprak, ka qenë 15 mijë euro. Dikun 73 mijë euro më shumë. Listën që ju e keni pru, që pretendohet që është sqarim, nuk ka kurrnifarë sqarimi, për mua është absoure dhe e papranueshme që, Komuna e Vitisë me nda shuma kaq të larta për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, kur nuk e dimë se ku janë tu shku ato këshilla profesionale, andaj këtu në kuvend komunal dua ta ngris këtë çështje, sepse e kemi diskutu edhe arsyeshmërinë e lidhjes së kësaj kontrate, që ka pas nevojë Komuna e Vitisë arsyeshmërinë me sjellë. Tjetra është, unë kërkoj këtu haptas një far lloj raporti të këtyre shërbimeve profesionale që po pretendohet që janë tu dhanë, dhe që janë tu shpenzu kaq shumë mjete financiare, me pa se ku janë ato dhe ku është rezultati, cili është përfitimi i qytetarëve në këto shërbime. Është absurde njerëzit me u pagu me mijra euro dhe me u shpenzu parat e bxhetit me këto shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Dhe tjetra është, çka e ka pas kaq me ngut, diku 73 mijë euro më shumë me ba pagesë me vitin paraprak. A tash që është në përfundim, për shkak që është tu kry ky mandat: a duhet krejt paret me i shpenzu, me i qu qëtu? Po për mu është e papranueshme që ky fakt, që diku 100 mijë euro i ke veç këtë 3-mujorin e parë për shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Ato shërbime nuk dihet ku janë shku, nuk dihet kush po përfiton prej tyre, a po përfitojnë grupet, njerëzit, personat e caktum, a po përfitojnë qytetarët. A kemi shërbime cilësore? Cili është rezultati i këtyre këshillave? Për mua kjo është begi shqetësuese. Dhe një pyetje, te kodi 13780, shpenzime për derivate, automjete, gjenerator dhe makineri janë 13 mijë e 981 euro. Edhe këtu kemi parë një rritje të shpenzimeve. Nëse e krahasojmë me vitin paraprak, diku prej 11 mijë euro ka rritje, dhe këtu kisha dashtë një përgjigje: cili ka qenë indikator që ka bërë me u rritë shpenzimet prej vitit paraprak?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Ju uroj punë të mbarë këtë masdite. Një çështje duhet ta kemi të kuart që, këto pasqyra financiare paraqesin një raport në një periudhë kohore të caktum, këtë rast prej janarit deri në mars, të cilët nuk mund me ndryshu askush, por ta paraqet një gjendje reale. Nexhati si ekonomist i ngriti këto çështje tek të hyrat vetanake. Një mos përputhje në planifikim, në realizim, tatimi në pronë, ofiqaria, gjeodezi, leje ndërtimi, taksa për legalizim, tu e përjashtu te tatimi në pronë, Nexhati që mujmë saktësisht me i marrë fakturat dhe me bërë një planifikim real, por mos realizim në 3-mujor gjithëherë është deri në muajin e 3-të që as nuk mund me i shpërnda fakturat, dhe ke një shkallë pak më të dobët, ndërsa te ofiqaria, gjeodezia, leje ndërtimi, taksa për legalizim është varësisht prej kërkesave të qytetarëve që mund nganjëherë me dalë shumë më e lartë nganjëherë më e ulët, sepse nuk ka kërkesa të qytetarëve. Ajo që e pat gjatë raportimit të drejtoreshës, ti Nexhat e ke nxjerrë dhe në përqindje, por e shënova këtu një çështje kur e bëni raportimin thotë: 1 milion e 94 mijë ke shuma që janë ekzekutu nga ana e vendimeve gjyqësore përmes Zyrës së Thesarit, dhe jo rasisht thashë më herët, kemi shumë që na ka prish dhe strukturën buxhetore të cilën e keni aprovu ju dhe kurrë nuk e mbylli atë që, 100% mund të jetë kontrata kolektive, mund të jetë edhe ndonjë vendim tjetër të cilin ti e dinë mirë se, komuna pas mbylljes së vitit fiskal i pranon të gjitha fakturat të cilat janë të paegzekutume, dhe në rast se vonohesh aty, ai e qonë në ekzekutim, dhe ti merrë ato mjete dhe mund të ndodhë që ka të tilla, por janë të pakta në krahasim me kontratën kolektive. Edhe te unë e ka ngritë një shqetësim mirëmbajta dhe riparimi i automjeteve. Obligimet që janë të komunës ndaj operatorit që i kryen ato punë, megjithatë krejt këto na i ka bërë mollë sherri. Tash mund të ndodhë që, ka marrë dhe nga ky kod, por në momentin që i kanë parashiku drejtoritë, i kanë marrë dhe aty, dhe tani na shkaktojnë telashe. Te kjo ndërtimi i palestrave sportive, një operator e ka njëra tjetrën. Mund ta ketë, por si kodë buxhetor kur e kemi shti e kemi shti ndërtimi i palestrave sportive. Tash dhe te shpenzimet i ka paraqit, ndërsa për skjarim, ndoshta në seancën tjetër mund ti marrim, se sa ju kanë pagu këtij operatori dhe sa atij operatorit.

z.Nexhat Halili: Nënkyetar, unë e kam analizu, dhe këto obligime janë të shkollës së Sllatines, të gjitha të "Euro Komercit". Unë e pata që, merrne dhe ndane në 2 pjesë, se janë 2 operator ekonomik të ndryshëm, se në bazë të listës, këto detajet e raporti për detyrime, fakturat të papaguara për vitin 2024 është e specifikuar. Dhe te

Drejtorja e Bujqësisë një pyetje për obligimet e këtij operatorit “Ost produkt”, 15 mijë e 976 euro: pse ka ndodhë me pas obligime për subvencionim të fermerëve. Tash e ke dhe 9 mijë e 970 euro te kryetarit. Tash nuk pe dimë kryetari çka ka subvencionu brenda kësaj periudhe 3-mujore.

z.Naim Pira, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nuk ka të bëjë këtu me subvencionim të fermerëve, ka të bëjë me pajisje të cilat i kanë marrë fermert në vitin paraprak, dhe nuk ka pas mjetet të mjaftueshme në vitin 2024 të kryhen nga operatorët, dhe në vitin 2025 ajo shumë prej 15 mijë e 600 euro, më duket në momentin që është aloku, ju ka pagu operatorit që ka pas tenderin. Kodi është i tillë, se ndryshe nuk mundesh me quajt atë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Nexhat, pyetjen që e shtrove, ndërtimi i kanalizimeve, e di që në Ramisht ka qenë nëpër disa lagje, më saktësisht muj me ti pru sot një javë, ndoshta Zyra e Prokurimit mundet me ditë më saktësisht, pasi qenkan këtu. Majlinda thotë nuk është raportim real. Nuk ka qare pa qenë real. Nuk mundesh me ju largu kësaj çështje, se kjo është sistemi. Nuk mund me qenë ndryshe. E ngrite një çështje që ndoshta ka nevoj për skjarim. Thua shërbime këshilldhënëse shumë. Këto janë shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, janë marrëveshje me AZHR, UNDP, projekte për eficiencë dhe marrëveshje me Crosborderin. D.m.th krejt këto e kanë kap këtë shumë, dhe varësisht prej këtyre marrëveshjeve ngritet edhe çështja, se kur i ke pagu është kjo shumë 11% rritje e derivateve. Ato mund me tu bartë ndonjë borxh i vitit të kalum, por munden edhe me u shpenzu, varësisht nga rrethanatat, por mund me qenë edhe ngritja e çmimit të derivateve, me qenë me litër. Ndoshta mund me krahasu, por me çmim mund të jetë ndryshimi i çmimit prej vitit në vit, ndërsa ne as nuk e japim atë tenderin, janë cetralizum në nivel qendror. Ne bëjmë pagesen e tyre ku furnizohen.

z.Bekim Azizi, kryesues: Faleminderti për kontributin që dhatë! Kjo pikë nuk votohet, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Kllokotit, Ranillugut, Ferizajt, Kaçanikut, Shtimës, Hani i Elezit, Shtërpçës

z.Basri Aliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne kemi sjellë planin ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, ku hynë të gjitha komunat që janë në këtë rajon. Materialin e keni marrë me kohë. Ky material është punu nga grupet punuese të të gjitha kounat që kanë qenë dhe të komunës sonë, por edhe me GIZ-in Gjerman, i cili ju ka ndihmu dhe ka hartu një plan të përgjithshëm. Ky plan është shumë i detajuar dhe vuluminoz, i ka diku 10 kapituj dhe nënkaptuj të tjerë që janë brenda saj dhe është i punum në atë mënyrë që, prej secilit legjislacion që ka qenë edhe ai europian, por edhe i Republikës së Kosovës është paraqitë në këtë plan: dhe ku janë bazu, për çka kanë vendosur në këtë mënyrë? Nuk do ta zgjasë më shumë, pasi materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Bekim Azizi, kryesues: Ky plan është i punum prej 7 komunave, është inicim prej GIZ-it, është për 20 vjeçar, që është kusht i BE-së, d.m.th të gjitha kuvendet komunale kanë me miratu planin e njëjtë. Pasi që nuk ka për debat e qesë në votim. Pra, me të gjitha votata pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe ky plan.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështjetjen financiare në shumën prej 3500 euro për Sindikatën (SPAK) e të Punësuarve në Shërbimit Civil në Komunën e Vitisë

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Para jush e keni në propozim vendim për mbështjetjen financiare në shumën prej 3500 euro për Sindikatën (SPAK) e të Punësuarve në Shërbimit Civil në Komunën e Vitisë. Unë e di që më herët pat zëra që pse ky propozim nuk është përgatit më herët, ndoshta ke qenë dhe shumë me vend, por megjithatë ekzekutiva punon në bazë të kërkesës. Kërkesa na u bë në këtë kohë në përputhje me kërkesën, ne kemi përgatit propozim vendimin, megjithatë edhe si Zyre e Kryetarit kemi qenë propozues të kësaj. Kryesues,

e kam një plotësim. Vendimi i plotëson të gjitha, por i mungon një nen. Nuk kemi thënë që pas pikës 3 të vendimit duhet me u shtu pika 4, që mjetën nga ky vendim të derdhen në gjyrollogarinë e sindikatës së pavarur dega në Viti, duhet ta specifikojmë dhe këto nenet tjera pasojnë, mas pikës 3 duhet me ardh kjo.

z.Ali Bajrami: Pas shpjegimit dhe elaburimit që bëri nënkryetari, pas konsultës së grupit të këshilltarëve të LDK-së, ne si grup parlamentar e mbështesim këtë vendim për ndarejn e 3500 euro Sindikatës së Shërbyesve Civil të Komunës së Vitisë.

z.Musli Neziri: Edhe ne duke e ditur gjendjen e punëtorëve të administratës ose sindikatës së tyre, duke pas parasysh që edhe më herët kemi pas kërkesa të tjera, edhe më herët i kemi përkrah së paku si kuvend, por na është kthi nga ministria si vendim i kundërligjshëm në atë pjesën e shujtave, ne jemi çdo herë si PDK në përkrahje të tyre. Prandaj, kërkojmë që, kjo të realizohet, aty është kerku që për 1 maj. Uroj që mos të jemi të vonuar, që tu realizohet kërksa ashu si e kanë bërë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Unë vetëm një shqetësim e kam që, është bërë propozimi prej mjeteve nga subvencionet, që më herët kemi pas një vendim që na është kthi prej ministrisë, kur kemi bërë një vendim prej subvencioneve, d.m.th kuvendi për qendren e rehabilitimit atje, mirëpo duke u bazu në 2 vendime që na kanë pru komunave tjera që jan të njëjta që i kanë nda kuvendet komunale, që i ka pranë ministria si të ligjshme, atëhere mendojmë që, edhe te ne të kalon si i ligjshëm.

z.Illir Zuka: Unë po mendoj që janë të ndryshme, se atë të paren që na e kanë kthi, ata kanë qenë të regjistruar si OJQ. Këta janë sindikatë, po besoj që nuk përputhen njëra me tjetren dhe besoj që ka me kalu.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet kjo pikë? Pra, me 15 pro, 0 kundër, 1 abstenim. Parimisht dhe pjesa që nuk voton zakonisht konfirmimi çka kam marrë prej ministrisë thotë që, janë abstenim, nëse nuk merrë pjesë në votim. Pra, kalon kjo pikë.

z.Majlinda Shabani: Një sqarim, edhe nëse bëhet me kalu, se këta e kanë bërë kërkesën për 1 maj. A bëhet ekzaktimi i mjeteve për 1 maj, a kryhet? Mbi të gjitha unë shpreosj që është brenda kuadrave ligjor.

z.Bekim Azizi, kryesues: Vazhdojmë me pika tjera.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e luajtshme, e cila evidentohet në pronësi të Xhavit (Januz) Bajramit

znj.Hidajete Aliu, udhëheqëse e tatimit në pronë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë në Viti, ka një propozim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, e cila evidentohet në emër të Komunës së Vitisë, me pronën e luajtshme private, e cila evidentohet në pronësi të perosnit privat Xhavit (Januz) Bajrami. Pjesa e parcelës prej 128 metra është pronë e komunës, e cila gjendet në Zonën Kadastrale në Viti dhe evidentohet në pronësi të Komunës së Vitisë jepet për këmbim, ndërsa merren pjesët e parcelave, pjesa prej 47 metrave katror nga parcela 2635 për 7 pjesë prej 43 metrave katror nga ngastra kadastrale 2635 për 34 dhe pjesa prej 38 metrave katrorë, e cila merret nga ngastra 2635/35. Të gjitha këto janë 128 metra sipërfaqe janë të barazume. 1 ari e 28 metra merret, ndërsa jepet 1 ari e 28 metra. Pra, materialin e keni marrë me kohë, mos të ju marrë kohë më shumë, për çdo pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Basri Aliu, drejtori: Çështja është te rruga "Nora e Kelmendit", diku në thellësi ku e ka shtëpinë personi në fjalë, dhe ai don ta bëjë shkëmbimin, sepse një pjesë e pronave të tyre është në pronë komunale, ndërsa një pjesë është pronë komunale në pronë të tijë. Ai don vetëm ta rregulloj pronën e parcelës së vet.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet edhe kjo pikë? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenin miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Informatë mbi kontratat e papërfunduara në tri vitet e fundit 2022-2024

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne, sipas kërkesës kemi përgatit një informatë mbi kontratat e papërfunduara për 3 vitet e fundit 2022, 2023, 2025. Materialin e

keni marrë me kohë, gjithsej janë 33 kontrata të cilat i kam qitë në raport, mund t'i shqyrtojmë, i shikojmë rreth punës së përfundimit të këtyre projekteve, edhe pse disa nga projektet janë 2-vjeçare, 3-vjeçare, janë në kontinuitet të zhvillimit. Ne sipas kërkesës kemi prurur këtë informatë për të debatuar rreth përfundimit të këtyre kontratave. Informatën e keni, besoj që nuk ka nevojë me i lexu të gjitha projektet, por jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e juaja.

znj.Majlinda Shabani: Para se me hy në diskutim të pikës së rendit të ditës, e para, ne kemi pas në mbledhje të komitetit, ku po besoj që diskutimet i kemi pas, por ideja ka qenë që me i pas të ftumë edhe inxhinierat, edhe kohën e raportimit për të cilën ne i kemi kërku kontratat me qenë në raportim. Në fakt nuk është ajo që ne kemi kërku, mirëpo mbi të gjitha, unë insisto dhe ka me inisist qe, duhet ndoshta një seancë e veçantë me i diskutu secilën kontratë veç e veç. Janë diku 33 ose 34 kontrata për të cilat kemi has shumë mos përputhje njëra me tjetren dhe problemi kryesor ka qenë te materiali i cili na është përcjell neve si asamblist. Nëse e merrni me lexu këtu, mundesh veç emërtimin e proejktit me pa, diku diku ki problem edhe shumën e projektit me lexu e leje më arsytimin a është me pranim teknik apo jo, a është në procedurë apo nuk është. Për mua kjo formë qysh ka ardh kështu në kuvend komunal është e papranueshme ose duhet me u prur si duhet ose kështu nuk mundemi me diskutu. Nuk ka logjikë me diskutu këtë kontratë, kur ne kemi kërku informacione specifike, dhe mos me i pas inxhinierat të cilët e bëjnë monitorimin e këtyre projekteve, dhe mos me i pas këtu prezent, nuk po na duhet, në këtë rast zyrtari i cili i rregullon këto procedura që janë të dokumenteve, mirëpo na duhet njerëzit adekuat të cilët dalin në teren e shohin a kanë në mbikëqyrje projektin, dhe mujn me dhanë informacione konkrete për secilin projekt.

z.Bekim Azizi, kryesues: Faleminderit Majlindë. Unë një kisha thënë që, të jeni në rend të ditës. Kemi kërku kontratën e papërfundime, nuk kemi kërku inxhinierat me fol për projekt. Kur flasim për projekt është çështje tjetër. Dihet që këto kontrata as nuk kanë pranim teknik as nuk janë të përfundum, ndoshta as nuk janë fer me u përfundu. Qëllimi jonë ka qenë gjatë 3 viteve të fundit me ardh kontratat e punës që janë të papërfunduara. Të gjitha këto punë janë të papërfunduara. Ne duhet me diskutu pse nuk po përfundohen këto kontrata, ku është telashja, se këto mbesin të hapura, mbesin si punë të pakryera.

znj.Majlinda Shabani: Tash nuk jam tu e bë diskutimin me pa, e ka kry punën e vet zyrtari i prokurimit si duhet. Unë jam tu e bë diskutimin për qytetarët e Komunës së Vitisë, të cilët janë të interesum me i pa projektet që bëhen në Komunën e Vitisë, për cilësinë e projekteve që bahen. Nëse kemi prur këtë me diskutu në favor të këtij zyrtari, këtu nuk jam i pajtimit nëse kemi me prur në kuvend komunal me diskutu çështjet që ju interesojnë qytetarëve të Komunës së Vitisë. Jam pro për me diskutu.

z.Bekim Azizi, kryesues: Për këtë pikë që kemi nuk mund me diskutu inxhinierat, por Zyra e Prokurimit. Ne mund t'i thirrjm për projektet të caktume në pika tejra, por për sot materiali që është prur është prej Zyrës së Prokurimit.

znj.Majlinda Shabani: Kërkesa jonë ka qenë ndryshe kryesues, po i deformoni, po i sjellni në kuvend si po ju konvenon. Kemi kërku para 2 viteve, 3 viteve vazhdimisht kemi kërku me diskutu specifikisht për secilin projekt në Komunën e Vitisë, që fillon, nuk përfundon, që pas 1 viti kur të investohet në atë projekt duhet me intervenu 2-3 herë në atë projekt. Edhe raportimet që bëhen kur të hynë ti me kap në dokumente zyrtare, e shef veç mënyrën e figurimit. Një kontratë mundesh me hi me lexu, nuk ki as vlera specifike për secilën zonë, rajon ku është edhe në web faqe. Ki mos përputhje nëse merrë me bë një analizë të mirëfillt mes shpenzimeve. P.sh.: që kanë bërë prej vitit 2022 deri në vitin 2024 dhe 2025, ku jemi tu diskutu me i kap me i krahasu me këto projekte. Ti rrjedhimisht nuk mundesh me nxjerrë asgjë aty dhe ne duhet me diskutu ajo çka është në interes për qytetarë e jo çka është në interes për personin zyrtar këtu, me pa a ka shku me i rendit emërtimet e projekteve siç duhet.

z.Bekim Azizi, kryesues: Kjo pikë nuk është me diskutu me mua. Unë jam tu thënë për këtë pikë çka është urdhëro diskuto me Zyrën e Prokurimit, kjo pikë nuk është e inxhinieranve, ne mundemi me shti një pikë në rend të ditës për filan projektin. E thirrjm inxhinierin. Ato inxhinierat kanë me ardh me folë këtu. Sot nuk mundem me ardh, se sot është pika për Zyrën e Prokurimit.

z.Nexhat Halili: Më së pari kam vërejtje në material. Unë nuk muj me lexu këtë material dhe nuk po e shof të arsyeshme me koment. Zyra e Prokurimit e ka përgjegjësinë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës. Pas kësaj, Zyra e Prokurimit më nuk e ka përgjegjësinë, e ka menaxheri i cili i përcjell punët, dhe kjo listë nuk është listë që kanë pranim teknik projektet, por është listë e investimeve në vijim. Investimet në vijim, kryetari i komunës në muajin e 10. 2024 ka formu komision. Ai komision është dashtë me bë këtë raport të investimeve në vijim. Kur janë investime në vijim, këto janë të paraqitura prej 2022 deri 2024, por ka projekte që janë nënshkru 2021 e jan vazhdu 2023 e po vazhdojnë deri 2025. Ku janë ato projekte? Po ta tregoj shembullin për trotuarin në Trestenik. Ai trotuar e ka vlerën mbi 800 mijë euro krejt, po ai trotuar nuk po përfundon. Tash është lidhë kontrata tjetër për trotuarin, por këtu është esenca pse nuk po përfundon ky trotuar, unë sot nuk muj në bazë të kësaj liste me bë pyetje. Nëse binë në seancën tjetër një listë tjetër të specifikohet edhe më e pastër. Grandi i performancës. Të gjitha kontratat janë lidhë, gati 2/3 muajt e fundit 2023, grandit i performancës është 1 vjeçar 2024, i ke 5 projekte që ende nuk kanë përfund. E ke rivitalizimin e rrugës “Hoxhë Jonuzi”, “Muhamet Muharremi”, ende ka obligime ndaj operatorit ekonomik. Ky është i grandit të performancës. Rregullimi i rrugës me kalldrëm rreth “Moravës”, edhe kjo është me grand të performancës. Rregullimi i rrugës, trotuarit “Agim Ramadani, ky është i perdunum ky nuk figuron në këtë listë a është bërë pranimin teknik i kësaj rrugës, a mundeni me specifiku se eprveq kontratës bazë e cila është 148 mijë e 111.50 euro është edhe aneks kontrata prej 13 mijë e 756 euro në aneks kontrata të rrugës Agim Ramadani figorn një emër i një rruge krejt tjetër rruga Xhemajl Ademi pse ka ndohë kjo. Te qyteti e ke fazën e dytë, plus dhe fazën e tretë. A ka përfund faza e dytë dhe ku është gjendja e fazës së tretë? Këto janë grande të performancës, edhe grandit i performancës në fazën e tretë 270 mijë euro. Ka janë marrë këto pare, ku grandit i performancës për tjera procedura veç e ka mbulu. A mundeni me i spjegu këto. Tash për në të ardhmën, për grand të performancës ka i merrni paret me i mbulu këto projekte? Duhet me i marrë prej investimeve kapitale të komunës. Te rruga Sllatinë-Viti, shenjat e komunikacionit askund nuk jan vendos. Vlera e planifikume ka qenë 390 mijë euro, kontrata është lidhë 544 mijë euro. Po më e keqja që është, në vitin 2021 ka qenë një kontratë tjetër 244 mijë euro, e lidhun me të njëjtin operator ekonomik që ndërprehet ajo kontratë dhe fillon me të njëjtin operator në 2022, dhe ende ka mbetë ajo rrugë me një vlerë kogjo të madhe, 544 mijë euro është lidhë kontrata e 3-të, se e para ka qenë 224 mijë me një operator tjetër, veç për zhavorr. Pse tash kjo rruga Sllatinë-Viti me ardh në këtë gjendje, mos me u bë pranimi teknik.

znj.Majlinda Shabani: Unë e kam tani një kontratë që është titulli i kontratës, asfaltimi i rrugëve rurale në Komunën e Vitisë, është vlere diku 2 milion e 352 mijë e 579 euro. Kjo kontratë është nënshkru me datën 26 nëntor të vitit 2024, është nënshkru kontrat për asfaltim të rrugëve rurale në Komunën e Vitisë në vlere 2 milion e 352 mijë, ku na e dimë që kesi kontrata me kesi titulli kemi pas edhe në vite paraprake, e kur po e diskutojmë ne çështjen për me i pru qeto punime që janë bë, a kanë pranim apo nuk kanë pranim teknik tash nuk mundem unë pyetjen me ja bë zyrtarit përgjegjës, se në këtë pyetje këtu mundet me mu përgjigj vetëm kryetari i komunës, se unë e di pse e ka bë këtë titull të kontratës edhe e di pse e ka kontraktu këtë kontratë. Këtë e dinë krejt qytetarët. Për qeta ky zyrtari këtu nuk mundet me u përgjigj në qeto pyetjet që ne i kemi. Tjetra, nëse hin tash në web të komunës, nuk i publikon prej viteve paraprake. Në momentin që hin me e pa asfaltimin e rrugëve rurale në Komunën e Vitisë, p.sh.: për vitin 2023 ose 2022 nuk e ka pas kontratën të nënshkrume edhe per vitin 2022-2023, po këtu kanë figuru për vitin 2024. Nëse hin me pa në web, nuk i publikojnë as ku lokalitetet, se ku janë bë qeto asfalte, madje nëse hin në e-prokurim, ti qet ty vendet se ku është bë qajo asfaltimi, mirëpo nuk i specifikon vlerat, s’di sa ka kushtu ai asfaltim që është bë. Tash pyetja është: pse nuk i publikojnë qeto vlere? Edhe tjetra, qeto kontrata, shumica prej këtyre, sidomos tek hapësirat gjelbëruese, palestrave, janë projekte të cilat ne i kemi në vazhdimësi prej vitit 2021 të cilat vazhdojnë me qenë. Nuk mundemi ne me dal me e disku një projekt i cilin është i vitit 2024-2025, ku kemi projekte të cilët kanë qenë të kontraktume prej vitit 2022-2023, dhe që ne po kërkojmë me i pa ato punime a kanë apo nuk kan pranim teknik, me i pa edhe qytetarët e Komunës së Vitisë, mandje me komentu edhe pjesën e cilësisë së punimeve që bëhen. Disi për mu është pak e papranueshme me dal na me disku këtë, përpos kritikave që i patëm në matrialin që u sjell.

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Sa i përket çështjeve të ngrituara, unë e kam pas një kërkesë për me e përgatit këtë informatë. Në kërkesë nuk keni specifikuar asgjë të kërkuar siç po e kërkon tani, se kërkesa e juaj ka qenë e përgatitne. Një informatë për projektet e papërfunduara 2022-2024. E kjo është informatë. Nëse ju doni detale, ka qenë dashur në kërkesë me cek, e du këtë detal, këtë detal, e ne e kishim përgatit për çdo detal informatën. Kjo informatë ka qenë përgjithësim për me e nxitë një diskutim, mirëpo mënyra tash qysh po thuani se keni ba kërkesë, ju lutem qitma ta shof kërkesën si e keni bërë, e nëse unë nuk e kam prurë një kërkesë që e keni kërkuar ju, unë jam përgjegjës, ama unë e kam prurë ashtu siç e keni kërkuar ju. Sa i përket çështjeve të ngrituara nga Nexhati, unë e di që të gjithë jeni politikan, këshilltar politik, edhe përfaqësoni një parti politike, dhe vërtet diskutimet e juaja janë politike, mirëpo kur një profesionist me shifra bënë politikë, atëherë është shumë gabim. Nexhat Halili, e kam në një katër herë a pesë e përmend rrugën "Agim Ramadani" edhe një punë shtesë. Nëse ma kish përmend këtë dikush tjetër ja kisha shpjeguar mirë, se e di që nuk po e kupton, po ky e dinë nëse një aneksesë është lidhë. Aneksi është produkt i kontratës bazë. Ky nuk e merr kontratën bazë me e shiku, po e merr aneksin, edhe nxitë temë, dhe aty janë vetëm 60 metra që i kemi vazhdu. Rruga "Agim Ramadani" është kry, ndërsa rruga, një krahë i rrugës që nuk e di saktë, po ju ka bërë ankesë dhe është qujt me emër, dhe pse aty është e parapamë, çmimet janë përdor të njëjtë që e lejon ligji, Ligjin e Kontratës me Procedurë të negociuar kanë qenë çmimet e njëjta, vetëm sasia, e kështu që kanë qenë 80 metra krejt. Vetëm aty një krahasim me marr del që ka qenë shkëlqyeshëm, e krymë kjo punë mirë, po kush do me ditë me ngritë tema me bërë mjegull.

z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit: A është e mundshme nëse rruga "Agim Ramadani" është përtej lumit? nuk është afër, ngjitet me rrugën "Agim Ramadani". A lejohet aspekti ligjor, që kjo rrugë mu kanë pjesë e aneksit?

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Nuk ka të bëjë këtu me emërtime të rrugëve, se mundesh me pas punë 60% me një rrugë, e punë tjera ka sanskione. Mirëpo emri, titulli bëhet vetëm e asaj që është qenësore ajo që është kryesore. Shembull, kur të ndahen projektet, shërbime, mallra, 51% është furnizim. Ti duhesh me quajt kontratën furnizim, ani pse ke shërbime 49%, ligji e definon këtë. D.m.th, nuk është problem kjo, d.m.th edhe kjo është parametrat, paramasës janë të njëjta, përshtatjet janë të njëjta, asfalti është i njëjtë, vetëm janë rritë sasi që lejohen brenda 10%, me të cilën e kemi kry ne këtë procedurë, ndërsa sa i përket rrugës së Sllatinës së Epërme, d.m.th Viti-Sllatinë e Poshtme, Sllatinë e Epërme, rruga që pak më shumë na ka dal problematike. Nexhati i përmendi do shifra të cilat nuk i qëllon hiç, d.m.th e përmendi kontratën e parë jo të dytën. E para ka qenë 244, e dyta ka qenë 360, mirëpo kontrata 2021 është prishë. Jo vetëm kjo kontratë, por edhe shumë kontrata kemi prishë me vendim të Qeverisë së Albin Kurtit, për shkak lëvizjes së çmimeve. E ka lëshu një informatë me të cilën ka thënë, çdo operator ekonomik që nuk ka interes për shkak të lëvizjes së çmimeve në treg dhe krizës ekonomike, mund të shkëputin kontrata pa penalizim. Ne kemi shkëput kontrata pa penalizim, që kanë qenë disa, jo 1, por njëra nga to është edhe kjo, dhe rritja e çmimeve pastaj dhe rritja e paramasës dhe zgjerimit ka ndiku që, çmimi i tregut të vjen dhe nëse e marrim kontratën e dytë ose të tretë, në këtë rast e krahasojmë me çmimet e tregut, ajo del që është kontratë shumë normale me çmimet e tregut, mirëpo nëse Nexhati si profesionist don me thënë se u rritë, u zmadhu, janë shtuar çmimet, ku duhet me thënë, asfalti është 10 euro në treg ti e ke bërë 20 euro. E atëherë unë marrë përgjegjësi. Mirëpo, nëse asfalti ka qenë në treg 12 euro e unë e kam 12 çmimin, atëherë unë nuk e di pse duhesh me diskutu këtë punë. Duhesh me nxjerrë argumente si produkt për me bërë një fakt. Kur e ke faktin mundesh me denoncu, por jo në mënyrë politike. Vetëm me ngritë një çështje sa për të akuzu. Mirë e tha këshilltari i LDK-së, nëse ke argumente qu shko qoj ku duhet. Mi qu amo jo me bërë tema këtu për me nxitë një debat ose një akuzë, ose një tendecë për me njollos dikën, me thënë që ke lidhë një kontratë të dëmshme. Nëse unë kam lidhë një kontratë të dëmshme, unë i dalë përball. Tani dhe dalim me çmimet e tregut, sepse nuk ka lëvizje të çmimeve aty qysh po muajna me parashiku, me thënë u rritë çmimi, 10 euro ke e u bërë 20 euro. Nuk ka, janë çmime të tregut. D.m.th i marrim 10 kontrata tjera i mbledhim, i përpjestojmë ato, dalin njëjtë. Është çmimi i tregut që variron. Lidhur me Majlindën, për asfaltimin e rrugëve rurale. Duhet të themë se, ka projekt, projekti ka emërtim, ka rrugë, ka skica, ka vizatime, ku janë ato edhe janë të prezentume. Nëse ti po thu që nuk po e gjejë rrugën që është pagu, atëherë vjen në zyre te ne i merrë,

ose e merrë projektin në Zyrën e Projekteve dhe i shikojmë rrugën 1 nga 1 ku i kemi punu, se janë të skicume edhe janë të matuna ato në paramasa, dhe krejt kanë çmim. Nuk mundet me u bë një rrugë e valla nuk kish çmim. Jo, ka çmim secila rrugë rurale. Çdo rrugë rurale në Viti ka çmim, mirëpo prej praktikave tjera kemi të bëjmë me një transparencë shumë evidente, një profesionalizëm shumë evident. Kush nuk donë me pa nuk e shef.

znj.Majlinda Shabani: Unë konsideroj që, në moment që don me përpilu një argument, duhet me pas edhe materiale shtesë ku ti mundesh me pas qasje. Kritika ime paraprake ke që, ne nuk po kemi qasje të plotë me dokumente me pa dhe me kriju argumente. I keni pru dikun 7 faqe, që vetëm janë emërtime. Për vitin 2022 janë 6 projekte, të cilat kanë qenë të nënshkrume, që figurojnë këtu. Në vitin 2023 janë vetëm 13 projekte. Për këto 6 projekte për vitin 2022. Sa prej tyre kanë pranim teknik dhe sa prej tyre nuk kanë pranim teknik, dhe sa vite dhe sa kohë duhet me u përfundu këto pranime teknike? Se po themë po lidhen kontrata tjera të reja, përderisa kontratat që kanë përfundu, punimet që kanë përfundu nuk kanë pranim teknik. Në anën tjetër ai projekt lëshohet në shfrytëzim për qytetarët e Komunës së Vitisë. Qysh funksionon kështu?

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Ju keni kërku kontrata pa pranim teknik. Nuk ka pranim teknik asnjë kontratë që ke para vetes. D.m.th, janë të papërfunduara. Ke lypë informatë ose raport, nuk ke lypë dokumente që prezentojmë për projektin. Kur ta bëni kërkesën, lyp dokumente për secilin projekt për me prezntu, faktin me ndërtu, jo me ndërtu me hipotezë.

z.Nexhat Halili: Të gjitha përgjigjet që i ka dhënë i ka dhënë jo të sakta. E para, grandit i përfornaces. Unë e kuptoj që rruga bazë ka qenë "Agim Ramadani", po hyni shihni brendësinë e shefni që krejt tjetër rrugë. Është e vërtet që Ligji i Prokurimit Publik thotë kështu: çmimet e aneksë kontratës duhet të jenë të njëjta ose më të ulta, po ky në dy pozicione i ka më të larta. Pozicioni numër 2.2 dhe numër 2.3, te rruga Sllatinë-Viti, ky i dha disa informata, por nuk janë të sakta. Ne t'i merrë ne t'i analizon kontratat dhe ne t'i shef. Kontrata e parë është lidhë me 26.10.2021, 224 mijë euro. Kontratën vetë e ka lidhë. Kjo kontrata e 2021-ës është anulë. 244 mijë euro ka qenë me operator tjetër, 224 mijë është me këtë operatorin ekonomik që është 224 mijë e 667 euro, e nuk është 360 mijë që ky po deklarë. Po e fundit, kontrata e tretë është planifku 390 mijë, është lidhë 544 mijë. Tani te rruga "Agim Ramadani", ja ku e kam letrën, asfaltimi i rrugës rurale, rruga "Agim Ramadani", degëzimi Viti, që është me një krejt tjetër projekt.

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Sa i përket grandit, grandit i përfornacës është 1 vjeçar, por grandin e përfornaces ne e kemi shfrytëzu edhe me mjetet tona, dhe e kemi bë 2-vjeçar, prandaj nuk mundesh me u thirrë në grand, kur grandit është me participim të komunës, sepse grandin që na kanë pru, ne kemi bë 5 llote. 5 llote nuk na kanë mbulu, dhe kemi arritë që 3 llote janë grand dhe 2 llote janë me investim të komunës. D.m.th paret jan lëshu për grand, janë lëshu edhe prej buxhetit të komunës, edhe janë vjeçare. Jo 1 vjeçare grandet i kemi shfrytëzu në maksimum. Me sa jam i njotum, d.m.th qysh vitin e parë janë shfrytëzu, mirëpo kur na kanë dalë edhe disa tjera kemi arritë pa i kry. "Agim Ramadani", unë ja shpjegova, ky nuk po donë me marrë vesh, nuk është problem puna për të, ndërsa Sllatinën prapë e ngatërroj. Po më vjen keq Nexhat, mos e ngatërroj. Sa i përket Sllatinës, faza e parë ka qenë hapja e trases. Operatori ekonomik, më sa më kujtohet ka qenë "Murseli". Ajo është kry faza e parë ka pranim teknik. Fazën e dytë kur kemi dalë kemi lidhë një kontratë për vitin 2021, për asfaltim, dhe ndërkohë kanë fillu operatorët ekonomik me bë ankesa në qeveri, për shkak të lëvizjes së çmimeve, dhe qeveria ka dhënë leje, kemi prishë kontrata pa penalzim. Çdo operatori i kemi shkru letra, a je interesum me vazhdu me këto çmime apo donë me prishë kontratën. Kush ka pas interes i ka prishë, disa nuk i kanë prishë, kanë pasoja ende. Unë po themë që ndryshe është kur fol për politikë. Politikan kam qenë, di me fol për politikë, edhe di me ja u dredhë, por kur fol profesionisti duhet me fol me argumente. D.m.th, ky prapë i përdor 2 vlera. Thotë, kjo edhe kjo, po nuk e ka bazën e çmimeve pse është rritë. Nëse ky e nxjerrë një çmim, që thashë unë u rritë, e kam bë asfaltin prej kontares së parë 10 e kam bë të dytën 20. Qe ku e ka rritë çmimin. Është argument. Mirëpo, ti nëse çmim të tregut e ke pas asfaltin 12 ose 13, se më herët ka qenë 7cm 7 euro, 8,9, dikur është bërë 11, 12, 13, d.m.th është rritë për shkka lëvizjeve në treg. Çmimet kanë qenë të tregut. Nëse Nexhat Halili e dëshmon me çmime të tregut, d.m.th qat ndryshimin mes kontratave, unë jam këtu për

përgjegjësi, por nëse ky veç e akuzon me do terma, dhe donë me thënë që kjo është keq, por nuk e di pse është keq, nuk bënë, se kjo është politikë.

z.Nexhat Halili: Vlerat që i jep ky nuk janë të sakta. Qaty është problemi, se kontrata parë është 244 mijë e nënshkrume prej “Murseli Kompani”. Ky po e ndryshon. Dhe ka qenë çështja e zhavorrit. Tash me “Murseli Kompani”. I ke pas metrat krejt ndryshe, tash i ke krejt ndryshe. Unë po të kuptoj që 2021 e ke lidhë me 224 mijë euro me të njëjtin operator e ke lidhë në muajin e 8-të. Ti mu nuk më dhe përgjigje për trotuarin e Trestenikut që 3 vite ka fillu dhe nuk po përfundon. Ti nuk e ke atë përgjegjësi si ti e ke deri në momentin e nënshkrimit të kontratës. Prej momentit të nënshkrimit mbikëqyrjen e ka dikush tjetër, caktohet mbikëqyrësi dhe organi që e mbikëqyrë mbikëqyrësin. Për atë arsye kolegja i kërkoj inxhinierat.

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Mirë e ka Nexhati kur po thotë se, përgjegjësia e Zyrës së Prokurimit përfundon me lidhje të kontratës. Mirëpo, ata menaxhera i përgjigjen kryetarit. Edhe ato informata që i qojnë në Zyre të Kryetarit i qojnë dhe në Zyre të Prokurimit. Unë jam shërbimi profesional i kryetarit këtu, edhe kam të drejtë me dhënë informata për këto që i disponoj. Nuk do të thotë që nuk kam të drejtë, sepse këta gjithmonë ju përgjigjen ZKA-së, Zyra e Prokurimit është shërbim profesional për ZKA-në. ZKA-ja nuk mbanë raporte, i mbajë unë raportet për ta dhe i kam raportet edhe mujë me i diskutu. Nuk mundesh me ma marrë të drejten me thënë se nuk i di, sepse i di, sepse kur raportojnë te kryetari raportojnë edhe në cc te Zyra e Prokurimit. Unë i kam edhe këto punë profesionale, nuk ka nevojë me ja qitë ZKA-së me ardh me ti spjegu kryetari, kur unë jam profesional për këtë punë dhe unë i shpjegoj. D.m.th kjo është dallimi. Pse po me merrë të drejtën kur nuk po i pëlqen këtij që unë po e di tash pse pe dinë ti. Nuk është punë e jotja, jo punë e imja është.

z.Ilir Zuka: A është një ndër ato shkëputjet e kontratave edhe stadiumi “Ibrahim Kurteshi”. Mos përfundimi me atë vendim që the, kryeministri i ka leju për shkak çmimeve, se tash e kuptova pse e ka shkëptu kontratën.

z. Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Po e njëjta është.

z.Nexhat Halili: Po është ndërpre kontrata, por ekziston edhe një rregullore, ku i përcakton çmimet që është lidhë në 2023, për kompenzim të operatorëve ekonomik, për shkak të inflacionit dhe pandemisë. Në shumë vende e keni përdorë. Pse nuk e përdorë edhe këtu?

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Pse ka qenë zgjedhe cilën dushë, ose ose.

znj.Majlinda Shabani: E para, kanë kufizu qasje në dokumente. E dyta, është ngritë niveli i diskutimit me rritjen e çmimeve. Tash kur të rritet çmimi, kur të bëhet investimi, qytetarët e Komunës së Vitisë kërkojnë që, edhe investimi me qenë cilësor e jo mas 1 viti që bëhet ai investim, ai asfalt me u prishë. Unë jam e intereso me ditë, në momentin që është bërë një projekt edhe në moment që ajo rrugë është prishë pas një viti, që është bërë ai investim. Hajde që ka pranim teknik, nuk ka pranim teknik, po deshka procedura, por mu po më intereson me ditë, a keni pas ndonjë rast deri sot që është ndëshku dikush për mos cilësinë e punimeve që janë bërë në Komunën e Vitisë pa plotësimin e kriterve që është shtru asfaltimi natën e ditën, pa kurnifare kriteri. A ka naj kush që merrë përgjegjësi apo që është ndëshku dikush. Unë thashë që këto përgjigje i kish dhanë i pari i komunës, se unë të garantoj që, kontrata që është lidhë për asfaltimin e rrugëve rurale, pa kurnifare planifikimi, 2 milion e gjysmë euro, në vitin 2025 mu lidhë kontrata për asfaltimin e rrugëve rurale, kjo është erë fushate, këtu planifikim nuk ka, por këto përgjigje s’unë i jep zyrtari, këto përgjigje i jep kryetari i komunës kur të vjen këtu, edhe mandej kur të vjen koha e fushatës së dikujt ja qonë asfaltin para derës së shtëpisë, e ka disa kërksa që janë bërë para 3-4 viteve, apo para 10 viteve, që nuk janë merrë kurrë, se nuk ka buxhet të mjaftueshëm, ama kur t’i intereson kryetartit, brenda ditës bëhet buxheti i mjaftueshëm, këshilltar komunal, pikërisht për shkak mos durimit që keni gjithsecilit prej juve, për shkak të rëndësisë që ka ky dokument me ardh me u diskutu. Këtu kemi kërku që, kjo pikë me pas një trajtim të veçantë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Pasi që po thirrësh shumë që nuk është kryetari këtu, jam unë tu e zëvendësu. Po thu a ka kompani. Po unë përgjigjet nuk t’i japi qysh ki qef ti, po qysh e kemi gjendjen reale. A ka kompani që po thu që, e keni sanksionu. Ka kompani plotë që e kemi rikthy me përsërit, me bë projektin prapë qysh e kemi lypë. Ka kompani plotë që kemi rikthy me e përmbush projektin qysh e ka me paramas dhe parallogari. E din këtë edhe menaxheri i prokurimit, e di edhe unë, e dimë edhe rrugën që ka qenë këtu për Viti,

që ka qenë që thojshi 3 here, por për të nuk është bërë pagesa 3 here, po për shkak kualitetit të dobët. Edhe rruga tani të "Toplant", në Remnik, dhe janë plotë raste të cilët janë kthyer, ku ka pas garancion të kontratës. Majlindë, po më duket mos po shterresh deri në zgjedhje tu e përmend Sokolin e po e hupë kondicionin.

z.Fadil Abazi, udhëheqës i Zyrës së Prokurimit: Majlinda prapë e përmendi këtë kufizimin në qasje, që thashë nuk është e vërtetë, sepse nuk keni kërku materiale, nuk ka kërku kush materiale. I drejtoheni Zyrës për Informata dhe për Qasje në Dokumente, dhe i merrni krejt materialet, edhe qytetarët i marrin, ndërsa sa i përket kontratës për rrugë rurale që kemi lidhë, ajo absolutikisht nuk mund me qenë politike, sepse është në kornizë afatmesme buxhetore planifikimi, edhe ka qenë e planifikume, dhe ta dini që asnjë kontratë nuk lidhet edhe asnjë procedurë nuk shpallet nese nuk e ka planifikimin. Nëse nuk janë planifiku 2 milion për 3 vite, unë nuk muj me shpallë, se është vepër penale, prandaj ajo është e saktë, që nuk ka asgjë politike. Planifikimi është për 3 vitet e ardhshme 2 milion, me i rregullu rrugët dhe rrugicat nëpër Komunë të Vitisë. Është e planifikume me kornizë afatmesme buxhetore, nuk ka politikë aty.

z.Bekim Azizi, kryesues: Sa i përket materialit, shihet që nuk shihet mirë. Ajo çka është kërku si material është kërku kontrata e pa përfundime dhe e kemi sjellë. Çka të kërkonin në kemi mi shti në rend të ditës. Kjo është veç informatë, nuk ka nevojë me u votu. Fadil, kisha kërku një trotuar, në 2021 është nis në Smirë. Në të përfundon, se mes trotuarit kanë mbetë disa grapa, janë të rrezikshme.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për lejet ndërtimore gjatë viteve 2021-2025

z.Visar Demiri, drejtori: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Seancën e kalume është kërku një informata për numrin e lejeve ndërtimore gjatë viteve 2021-2025, dhe taksat e paguara për to. Drejtoria ka përgatit një informatë, e ka dorëzuar me kohë, dhe besoj që materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jam i gatshëm të jap sqarime.

z.Ali Bajrami: Drejtor, të përgëzoj për informatën që e ke sjellë. Unë në seancën e kalume e kam lyp, mirë që e ke sjellë pikë të rendit të ditës, edhe me këtë informata që ju e keni sjellë janë informu edhe këshilltarët komunal, por edhe qytetarët munden me pas qasje, ma pa në atë dokument çka ka, sa leje ka, sa janë të hyrat, prandaj unë të përgëzoj për këtë punë që ke bërë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Pasi që nuk ka për debat, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

8. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim për pronat e paluajtshme të komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike Sh.A KEDS në Viti, për vendosjen e trafove elektrike

z.Musli Neziri: Në bazë të materialit që na erdh, thuhet për 15 vite afat shkurt, me dhënë për 15 vite. Pse mos me qenë afatgjatë?

z.Nexhat Halili: Nënkyetar, unë e kam një kërkesë dhe për Trestenik, dhe aty ka nevoj për rrymë.

z.Bekim Azizi, kryesues: Ju e dini që në fund të vitit 2024 ne kemi miratu 18 prona për vendosje të trafove, ende nuk i kanë vendos të gjitha. Kësaj radhe i kanë kërku këto 2 KEDS-i.

znj.Liridona Bislimi: Unë po pajtohem me nënkryetarin që tha, dhe po më vjen mirë që më në fund është marrë parasysh, për shkak se një kërkesë e tillë, d.m.th prej mandatit të kalum, së bashku me kryetarët e fshatrave, me këshillin e kemi pas, d.m.th në parim prej kërkesave komunale, por edhe takimet i kemi bërë me KEDS çka ka pas nevoj. Unë lokacionin nuk mujta me kuptu, por besoj që është në pjesën tjetër të Drobeshit, për shkak që ajo pjesë ka pas problematika edhe në këtë kohë, e mos të flasim për kohën e dimrit.

z.Basri Aliu, drejtor: Vendi ku është caktu në Drobesh, unë vetë kam qenë në vend të ngjarjes aty me gjeometër dhe kemi përcaktu, e besa edhe dy qytetar të Drobeshit kanë qenë aty, dhe me marrëveshje me KEDS që ka thënë, me qenë sa më larg prej trafës, që është, dhe kemi vendos këtu të varrezat që është ajo hapësirë, një trekëndësh që kalon një rrugë aty, që mos me marrë hapësirën tjetër, por me shfrytëzuar atë hapësirë që nuk e pengon askënd. Gjithashtu kemi bërë dhe për Viti, të parku.

z.Bekim Azizi, kryesues: E qes në votim. Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë. Me këtë përfundojmë këtë seancë. Mirë u pafshmi në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Bekim Azizi



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilajeno Me Data 13-05-2025			
Nr. Dokument Org. Broj	Numri Broj	Shënim Problemi	Vlera Vendosje
02-	035/02-		441



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011 , Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

PROPOZIM VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE NGA TË HYRAT VETANAKE TË VITIT 2024 NË VITIN 2025

I.

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara të vitit 2024 në vitin 2025 .

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 – Mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, neni 9 - të ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak , pika 1,2 , bilancet e pa shpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, dhe pika 6 dhe 7 për Bartjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **230,520.86 €** në vitin 2025. Nga vlera e mjeteve prej 230,520.86 €, mjete të bartura e të pa shpenzuara nga viti 2024 janë prej **26,664.81 €** (të alokuara në kategori ekonomike dhe në programe sipas planit të buxhetit të vitit 2024) dhe rritje të buxhetit nga THV janë prej **203,856.05 €**.

II.

Bartja e Buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike :

1. Mallëra e shërbime në shumë prej	5,063.04 €
2. Subvencione e transfere në shumë prej	4,868.26 €
3. Investime kapitale në shumë prej	220,589.56 €

Të shpërndara në këto nën - programe buxhetore :

Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime shuma prej 5,063.04 €, në nën-programet :

- Zyra e kryetarit (16033) shuma prej 863.04 €
- Shërbimet e shëndetësis primare (74950) shuma prej 4,200.00 €

Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere shuma prej 4,868.26 €, në nën –programin :

- Zyra e kryetarit (16033) shuma prej 4,868.26 €.

Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale – në projekte ekzistuese shuma prej 220,589.56 në nën-programet :

Buxhetimi (17533) shuma prej 192,421.56 € në projektet:

- Participim i projekteve me donator kodi (90552) shuma prej 100,000.00 €,
- Blerja e autoveturave për administratën komunale në Viti kodi (58349) shuma prej 9,640.00 €,
- Rregullimi i rrethoive të shkollave(Bafti Haxhiu ,Halil Alidema) kodi (52817) shuma prej 4,929.77 €,

- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj kod (56310) shuma prej 25,000.00 €,
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Tërpez, Trestenik, Vërban, Smirë, Begunc, Gjylekarë, Ramnisht kod (53855) shuma prej 50,981.79 €

Shërbimet e shëndetësis primare (74950) shuma prej 11,263 € në projektin:

- Renovimi i ambulantës në Viti kod (53893) në shumë prej 11,263.00 €.

Arsimi i mesëm (95160) shuma prej 16,905 € në projektin :

- Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë kod (53880) shuma prej 16,905.00 €.

Arsyetim:

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 të miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve të mjeteve të mbetura të pa shpenzuara nga viti 2024.

Komuna ka tejkaluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2024 në vlerë prej 203,856.05 euro, (prej 4,200.00 € janë rritur mallrat e shërbimit, ndërsa, pjesa tjetër në vlerë prej 199,656.05 €, në shpenzime kapitale.

Bartja e të hyrave në vlerë prej 5,063.04 €, në kategorinë e shpenzimeve mallra e shërbime vlera prej 863.04 kan mbetur pa u shpebzuar dhe vlera prej 4200 € rritje në mallra e shërbime nga të hyrat e shëndetësis .

Bartja e të hyrave në vlerë 4,868.26 €, në subvencione e transfere bëhet se kanë mbetur pa u shpenzuar nga viti 2024 .

Ndërsa, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 220,589.56 €, në tetë projektet e ekzistuese bëhet nga tejkalimi i planit të shpenzimeve kapitale, për pagesën e obligimeve në këto projekte për të cilat kërkohej mjete shtesë, të pa paguara të kryhen obligimet financiare .

- Participim i projekteve me donator kod (90552) shuma prej 100,000.00 € për pagesën e projekteve të bashkëfinancuara me donator .
- Blerja e autoveturave për administratën komunale në Viti kod (58349) shuma prej 9,640.00 €- obligim i pa paguar.
- Rregulli i rrethojave të shkollave (Bafti Haxhiu ,Halil Alidema) kod (52817) shuma prej 4,929.77 €,
- Blerja e fotoapararit digjital profesional kod (55192) shuma prej 1,870 .00 €, obligim i pa paguar.
- Ndërtimi i tribunave të stadiumit në fshatin Skifteraj kod (56310) shuma prej 25,000.00 €,mjete shtesë nga planifikimi i buxhetit .
- Ndërtimi i fushave sportive në Zhiti, Terpez, Trestenik, Vërban, Smirë, Begunc, Gjylekarë, Ramnisht kod (53855) shuma prej 50,781.88 € obligim i pa paguar. \
- Renovimi i ambulantës në Viti kod (53893) në shumë prej 11,263.00 €, obligim i pa paguar.
- Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiyi, Goshicë, Vërban dhe Ramnishtë kod (53880) shuma prej 16,905.00 €, obligim i pa paguar.

Viti
Datë 13.05.2025

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Primbjen datë 30-04-2025			
Nr. i Org. Broj	Nr. i Org. Broj	Shifra e Përditë	Vlera Vrednost
02-	033/02-	406	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe sipas kërkesës nga Shoqata Sindikale e Policisë Rajonale në Gjilan, Kryetari i Komunës së Vitisë me datë 30.04.2025 paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR LIRIMIN NGA PAGESA PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË KOSOVËS PËR SHËRBIMET QË AFROHEN NË QENDRËN E MJEKËSISË FAMILJARE DHE INSTITUCIONET E TJERA SHËNDETSORE QË MENAXHOHEN NGA KOMUNA E VITISË

Neni I

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që ta shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën e Shoqates Sindikale të Policisë Rajonale në Gjilan, për lirim nga pagesa e punonjësve të policisë së Kosovës për shërbimet që afrohen në qendrën e Mjekësisë familjare dhe institucionet e tjera shëndetsore që menaxhohen nga komuna e Vitisë.

Neni II

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi, është kërkesës nga Shoqata Sindikale e Policisë Rajonale në Gjilan, e datës 11.03.2025.

Neni III

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale në komunën e Vitisë.

Neni IV

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

PROPOZUES :

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti





SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT POLICIE KOSOVA
KOSOVO POLICE UNION



MEMORANDUM ZYRTAR

Data 11.03.2025

Nr. i Ref:

PËR: z.Sokol Haliti
Kryetar i Komunës Viti
z.Bekim Azizi
Kryetar i Kuvendit të Komunës së Vitisë

PËRMES:

PREJ: z.Ragip Ajeti
Kryetar i Shoqatës Sindikale Policisë Rajonale Gjilan

LËNDA: KËRKESË

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem titullit të lartshënuar që ta miratoj lirim nga pagesa për punonjësit e Policisë së Kosovës, për shërbimet që ofrohen në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe institucionet e tjera shëndetësore që menaxhohen nga Komuna e Vitisë.

Prandaj kërkojmë mirëkuptim nga titulli i lartshënuar që ta miratoj lirim nga pagesa për kontrollet dhe nevojat mjekësore që mundësohen nga QMF Viti, për pjesëtarët e policisë së Kosovës që shërbejnë në Rajonin e Gjilanit.

Mbështetim shpresë se kërkesa e jonë do të shqyrtohet dhe do të realizohet si dhe të përkrahet nga Strukturat udhëheqëse të Komunës së Vitisë në bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë dhe institucionet vartëse të Drejtorisë së Shëndetësisë në Viti.

Si dëshmi kësaj kërkesë i bashkëngjies Vendimin e Kryeqytetit të Prishtinës me nr 01-020/01-238142/23 të lëshuar me datë 28.11.2024 që Miratohet lirimi nga pagesa për pjesëtarët e policisë.


Si dhe Vendimin e Kuvendit Komunal Gjilan, të datës 27.02.2025 me Nr.016-16471/25 që miratohet lirimi nga pagesa për punonjësit e Policisë.

Me respekt.
Me 11.03.2025
GJILAN

Kryetar i Shoqatës Sindikale për Rajonin Gjilan
Ragip Ajeti
Nr. Tel 044/212-103

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr.Mulla IDRIZI Pn.Gjilan - Kosovë
Drejtori Rajonale e Policisë





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Data 12-05-2025			
Nr. i Organiut Org. Broj	Numri Broj	Shtetëse Përfaq	Vlera Vrednost
12-	070/01-		431

2025

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

MANIFESTIMI TRADICIONAL KULTURO- SPORTIV “FLAKADANI I KARADAKUT 2025”

DKRS/ VITI



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë

Municipality of Viti/Vitina

Drejtoria për Kulturë, Rinidhe Sport

Department of Culture, Youth and Sports




DATE/A:	Maj, 2025
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal, Viti
NGA/ZA/FROM:	Z. Valmir Sahiti Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport
PËRMES/OD/FROM:	Kryesuesit të Kuvendit Komunal z.Bekim Azizi
C.C	Kryetari i Komunës së Vitisë z.Sokol Haliti
LËNDA:	Informatë për Manifestimin Tradicional “Flakadani i Karadakut 2025 ”

Përmbajtja

I.	DKRS – TRUPA KOORDINUESE E MANIFESTIMIT.....	4
	a) Ndarja e detyrave të Trupës Koordinuese.....	4
II.	RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE.....	5-9
	a) Aktivite Kulturore dhe sportive.....	7-9
III.	RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT.....	9-10
	a) Tabela e kostos totale buxhetore.....	9
	b) Tabela krahasuese (2024-2025) e shpenzimeve.....	10
IV.	MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT DHE MEDIAT.....	10

b). Ndarja e detyrave të Trupës koordinuese:



II. RAPORTI NARRATIV I AKTIVITETEVE

a) Aktivitet kulturore dhe sportive

- Hapja solemne – Dhezja e Flakadanit

Kemi organizuar dhe mbajtur manifestimin tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2025”, manifestim ky i cili është zyrtarizuar përmes Kuvendit komunal si ngjarja më e madhe kulturo-sportive në Komunën e Vitisë, në të cilin marrin pjesë nxënësit, sportistët, shkrimtarët, artistët dhe grupet artistike nga mbarë hapësirat shqiptare dhe më gjerë.

Ky ishte edicioni i 24-të me radhë, i cili u mbajt në sajë mbështetjes së projektit: “Flakadani i Karadakut 2025”, nga institucionet komunale si dhe organizimit nga ana e Drjetorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Manifestimi Tradicional Kulturor e Sportiv “Flakadani i Karadakut 2025” ka filluar më 24 mars, ku u bë hapja solemne e manifestimit me dhezjen e Flakadanit dhe është përmbyllur më 26 mars në mbrëmjen finale të festivalit mbarëkombëtar të ansambleve dhe shoqërive kulturore dhe artistike.

Në këtë manifestim përvec udhëheqjes komunale dhe shoqatave të ndryshme prezantuan edhe deputetët e parlamentit të Kosovës, zyrtarë qeveritar si dhe mysafir të shumtë nga Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia e Veriut.

Edhe në këtë edicion, pati risi dhe prurje të reja të cilat ishin në harmoni me karakterin e manifestimit tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2025”.

Aktivitetet Kulturore dhe sportive:

- **Garat regionale të recituesve** – u mbajtën në Sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 25 Mars 2025 me fillim në ora 11:00 Në këto gara prezantuan nxënësit e shkollave të mesme të komunave: Kamenicë, Gjilan, Viti dhe Kaçanik. Juria profesionale e përbërë nga përfaqësuesit e komunave përkatëse, vlerësuan që vendi i parë t’i takoi nxënëses nga Dardana Yllka Pireva, kurse vendi i dytë iu nda nxënëses Egzona Shabiu, ndërsa me vendin e tretë u shpërblye Ejona Zeneli.

Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si organizatore e manifestimit, ndau falënderime.

- **Ora e Madhe Letrare** – u mbajt në sallën e mbledhjeve të Shtëpisë së kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani” në Viti, më 26 mars 2025, me fillim në ora 11:00 Ku prezantuan shkrimtarë, poetë nga mbarë hapësira shqiptare. E organizuar në kordinim me Shoqatën e Shkrimtarëve “Ramadan Musliu” e cila hapi konkursin letrar, ku me poezitë e tyre kanë konkuruar poetë e shkrimtarë të cilët janë kualifikuar për Orën e Madhe Letrare dhe janë botuar në revistën “Flakadani i Karadakut 2025”.

Juria profesionale në përbërje prej 3 anëtarëve me kryetare Migena Arllati, ka vlerësuar poezitë më të mira të shkrimtarëve konkurrues të Orës së Madhe Letrare- “Flakadani i Karadakut 2025”.

Me çmimin e parë u nderua shkrimtari dhe poeti Ramë Oranca me poezinë “Rapsodi e 1432 engjujve”, çmimi i dytë i takoi Bajram Ali Selimit- Poezia “”Pesha e Flamurit”, kurse çmimi i tretë u nda për poeten Mimoza Zejnullahu nga Vitia.

Kurse çmimi kryesor “Flakadani i Karadakut” iu nda poetit Sabit Rustemi nga Gjilani me poezinë “Pikëlon pranverë gjaku”.

- **Festivali Gjithëkombëtar i Shoqërive Kulturore e Artistike** – u mbajt nga 24 - 26 Mars – prezantuan 12 -të Shoqëri Kulturore artistike nga Kosova, Shqipëria, dhe Maqedonia e Veriut, ku hapjen e festivalit e bënë solistët e mirënjohur Doarsa Sopa dhe Ismet Bexheti.

Mbrëmja e parë e festivalit, më 24 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria Kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	"Kemajl Azizi"	VITI	Jashtë Konkurrencës
2.	"Shqipet e Vogëla"	Mitrovicë	✓
3	"Jahi Hasani"	Çegran	✓
4.	AKV "Ilirida"	Shtime	✓

Mbrëmja e dytë e festivalit, më 25 Mars:

Nr.	Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore	Vendi	Vlerësimi i Jurisë
1.	"Jonuz Ramadani"	VITI	Jashtë konkurrencës
2.	"Selman Kadria"	Istog	✓
3.	"Gryka Kaçanikut"	Kaçanik	✓
4.	"Gurra e Kurbinit"	Laç- Shqipëri	✓
5.			

Mbrëmja e tretë e festivalit, më 26 Mars:

Nr.	<i>Ansambli, Grupi artistik, Shoqëria kulturore</i>	<i>Vendi</i>	<i>Vlerësimi i Jurisë</i>
1.	Q. K. "Anamorava"	Viti	<i>Jashtë konkurrencës</i>
2.	"Deçani"	Deçan	
3	"Kastriotët"	Ferizaj	
4.	"Shotë Galica"	Drenas	
5.	"Mati"	Shqipëri	
.			<u><i>Mysafire e festivalit</i></u>

Juria profesionale në përbërje: Mehmed Xhemajli koreograf, Sami Piraj muzikolog dhe Mustafë Lamallari profesor i muzikës, vlerësuan dhe ndanë 3 vendet e para, çmimin special dhe atë jubilar të Festivalit Gjithëkombëtar të Shoqërive dhe Ansambleve Kulturore Flakadani i Karadakut 2025"

Vendin e parë iu nda AKV "Mati" nga Shqipëria, vendi i dytë AKV "Kastriotët" nga Ferizaj dhe vendi i tretë i takoi SHKA "Shotë Galica" nga Drenasi. Ndërsa me çmimin special u nderua AKV "Gryka e Kaçanikut" nga Kaçaniku.

- ✓ *Më 26 Mars, me fillim nga ora 10.00, u bënë homazhe dhe vendosja e kurorave me lule te varrezat e dëshmorëve – Dëshmorit Nijazi Azemi – Komandant Mjekrra.*

Aktivitetet sportive:

- Garat sportive të shahut
- Garat sportive në gjimnastikë
- Garat sportive të basketbollit
- Garat sportive në futboll të vogël
- Haiking

Ku të gjitha ndeshjet u zhvilluan gjatë rrjedhës së manifestimit Kulturor dhe Sportiv "Flakadani i Karadakut-2025".

III. RAPORTI FINANCIAR I MANIFESTIMIT

a) Tabela e kostos buxhetore:

Fondi burimor	Lloji i shpenzimit	Kostoja në €
Komuna e Vitisë/DKRS	Akomodimi	580.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Zërimi	755.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Dreka dhe Darka (Shujta për grupet artistike dhe sportive)	7,170.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Plus TV	1,753.00 €
Komuna e Vitisë/DKRS	Shtypja e materialeve grafike katalogë, cerada citillajda, rollo, postera, shtypja në bez e flamujve beza, gravura, fotografi etj.	1,980.00 €
Totali:		12,238€

"Flakadani i Karadakut 2024"	Flakadani i Karadakut 2025"
17,691.18 €	12,238.00
-5453.18	

Tabela

krahasuese 2024/ 2025

IV. MBËSHTETËSIT E MANIFESTIMIT

Mbështetësit: Komuna e Vitisë-DKRS VITI

Mediat: Manifestimi Tradicional kulturor dhe sportive “Flakadani i Karadakut 2025”, u mbulua tërësisht nga “Plus Televizion” si dhe nga Tëvë1,T7,ATV, “TV Presheva”, Zyra për Informim e Komunës së Vitisë si dhe mediumet tjera vendore.

Rekomandimet: Manifestimi Kulturo - Sportiv “Flakadani i Karadakut” si njëri nga aktivitetet më të mëdha kulturore dhe sportive në Viti të vazhdoj duke e identifikuar Vitinë gjithandej trojeve shqiptare.

Viti, Maj 2025

Drejtori i DKRS:

/ Valmir Sahiti /





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbena Me Data 13-05-2016			
Nr. Llogarit Orig. Broj	Numri Broj	Shtetëse Punëtor	Vlera Vrednost
09-016/01			635

Informat për menaxhimin e mbeturinav në Komunën e Vitisë

I.HYRJE

Kompania Ecohigjiena Sh.P.K Gjilan – Njesia punuese Viti, ka të organizuara 4 Ekiye punuese në territorin e Vitise dhe shërbehen rreth 6213 klient, të kategorive të ndryshme.

Për realizimin e Planit te punues, kompania ka të sistemuar në këtë njësi punuese, gjithsej 21 punëtor, 13 prej tyre merren drejtpërdrejtë me grumbullim dhe transportim të mbeturinave ndësa 8 jane staf indirekt që e ndihmojn këtë Njesi punuese.

Me Planin e Menaxhimit të Mbeturinave janë parapa 3 objektiva:

1. Zgjerimi i shërbimeve 100%;
2. Përmirësimi i efikasitetit dhe kosos operative;
- dhe 3. Menaxhimi i kategorive tjera të mbeturinave - riciklimi i mbeturinave¹;

Misioni - Bartja dhe deponimi e mbeturinave;

- Ngritja e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e aktivitetit të saj;
- Mbulueshmëri në 100 % , e territorit të komunave;
- Trajtim të barabartë dhe qasje në shërbime për të gjithë klientët;

Vizioni - Përfaqëson orientimin afatgjatë të kompanisë si vijon:

- Ambient të pastër dhe ekologjikisht të qëndrueshëm;
- Shfrytëzimin racional të kapaciteteve dhe resurseve njerëzore dhe tekniko-teknologjike;
- Hulumtimin dhe ofrimin opsioneve përkatëse për zgjidhje të kërkesave ekologjike;
- Reduktimin e mbeturinave, ndarjen si dhe kompostimin e mbeturinave të kopshtit;

¹ Riciklimi - çdo operim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera.

I.1 Mbulimi me shërbime

Eco-Higjiena Sh.P.K Gjilan, Njësia punuese në Viti, mbulon me shërbime, qytetin dhe fshatrat:

Vendbanim	Ekonomitë familjare të shërbyera	Bizneset e shërbyera	Institucionet e shërbyera
Pozheran	468	91	7
Sllatinë e Epërme	191	2	3
Sllatinë e Poshtme	116	2	2
Stubëll e Poshtme	63	2	2
Lubishtë	66	2	1
Binçë	33	2	1
Devajë	32	2	0
Letnicë	10	4	0
Buzovik	15	0	1
Shashare	9	0	0
Ballancë	39	0	1
Podgorc	37	0	0
Zhiti	60	0	1
Gushicë	81	0	1
Gërmovë	71	3	1
Drobesh	180	6	1
Kabash	178	1	1
Beguncë	138	0	2
Ramnishtë	65	1	2
Gjylekar	127	1	2
Remnik	83	0	2
Vërban	85	1	1
Novosellë	50	3	1
Ramjan	80	1	1
Budrikë e Epërme	86	4	1
Tërpezë	78	2	2
Radivojc	132	7	1
Sadovinë e çerkezve	13	0	1
Sadovinë e Jerlive	172	1	2
Smirë	251	6	2
Tërstenik	32	0	1
Viti	1126	372	23
Gjithsej:	4167	516	67

Vërejtje: Ne listë nuk janë të përfshirë klientët nga diaspora dhe rastet sociale të cilët janë të liruar nga pagesa e shërbimeve .

1.2 Orari i grumbullimit të mbeturinave

Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave organizohet 6 dite ne jave, gjatë tërë vitit, duke mos përjashtuar edhe festat shtetërore dhe fetare. Bartja e mbeturinave bëhet kryesisht në turnin e parë, duke filluar nga ora 05 deri ora 13^h.

1.3.1 Bartja e mbeturinave nga amvisëritë

Për këtë kategori të shërbimeve, bartja e mbeturinave organizohet me kamion special ndërsa klientët janë të obliguar që mbeturinat t'i fusin në shporta (120 litra, kontejner te perbashket) apo në qese plastike. Klientët janë të obliguar, shportat t'i nxjerrin buzë rrugës gjegjësisht jashtë derës së shtëpis, ndërsa transportimi i tyre bëhet me automjete speciale Bartja e mbeturinave bëhet sipas orarit dhe terminit të caktuar kohor i cili nuk ndryshohet por mund shtyhet më së voni, deri në orët pas ditës. Në amvisni bartja e mbeturinave kryhet një ditë në javë.

Ekipi i punes perbehet prej: 1 Vozitesi dhe 2 punetor te cilet bejne zbrazjen e kontejnerve. Gjate sesones verore per arsye te shtimit te mbeturinave nuri i punetorve sezonal rritet

Per shkak te infrastruktures rrugore ne te cilat nuk mund te hyhet me kamion, deri 100 metra distance klientee duhet ti sjellin vet mbeturinat e grumbulluara ne nje pike te caktuar.

1.3.2 Bartja e mbeturinave nga objektet banesore

Në bazë Planit Operativ, bartja e mbeturinave nga objektet banesore bëhet duke i zbrazur kontejnerët e llojeve (1,1m3.), të cilët janë vendosur në pika të përbashkëta grumbulluese dhe afër objekteve të banimit.. Sherbimi ofrohet 6 ne jave.

Ekipi i punes perbehet prej: 1 Vozitesi dhe 2 punetor te cilet bejne zbrazjen e kontejnerve.

1.3.3 Bartja e mbeturinave nga institucionet dhe bizneset private

Bartja e mbeturinave në objekte të bizneseve ofrohet sipas planit javor dhe i mundësohet çdo klienti (Institucioni apo biznesi) që të ketë qasje të lehtë në shërbime, ndërsa disa biznese shërbehen së paku një here në javë. Kjo ndarje është bërë si rezultat i kategorizimit të rrugëve me prioritet kalimi dhe të rendit të dytë. Në pjesën dërmuese të bizneseve private, bartja e mbeturinave bëhet 6 ditë në javë. Ndërsa te disa ndërmarrjet komerciale dhe te një pjesë e bizneseve, bartja e mbeturinave bëhet sipas kërkesës së tyre përkatësisht sipas kontratës.

II. SISTEMI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE DHE MAKINERIA

Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave bëhet me Kamion speciale dhe shporta shtepiake te llojeve 120 litra si dhe kontejner 1,1m3, per tre kategori, si vijon:

II.1.

Kamionët për grumbullim dhe transfer				
Kamioni Nr. 1	MAN 26 320 TGS	12	2008	06-583-FG
Kamioni Nr. 2	MAN TGA 26 400	10.7	2004	06-623-EE
Kamioni Nr. 3	MAN	10.6	2012	06-216-GH
Kamioni Nr. 4	MAN	10.6	2011	06-373-FK

II.2.

Kontejnerë		
Kontejnerë 120 l	5962	(1- 3)
Kontejnerë 240 l	0	0
Kontejnerë 1.1 m3	185	3
Kontejnerë 4.5 m3	4	
Kontejnerë 15 m3 - Transfer		

- 1 Grumbullimi i mbeturinave në amvisëri,
- 2 Grumbulli i mbeturinave nga objektet banesore
- 3 Grumbullimi i mbeturinave nga bizneset dhe institucionet

Në biznese dhe institucione është lënë mundësia, që organizimi i grumbullimit të mbeturinave të bëhet në bazë të **kërkesës së palëve** (kontejner ose shporta) dhe kontratës së nënshkruar me palët. Numri i zbrazjeve së kontejnerëve bëhet sipas marrëveshjes së arritur me palët . Me rastin e zbrazjes së kontejnerëve lëshohet dëshmi e veçantë (urdhëresë shërbimi) për kryerjen e shërbimit.

FATURIMI DHE ARKËTIMI NGA SHËRBIMI I MENAGJIMIT TË MBETURINAVE VITI

Emri i operatorit	Kategoritë e klientëve të shërbyer	Faturimi (të hyrat)		Arkëtimi	
		Vlera €	Nr. i faturave të lëshuara	Vlera €	Nr. i faturave të arkëtuara
a	b	c	ç	d	dh
Eco-Higjiena Sh.P.K - Nj.Viti.	Amvisëritë	351,793.81	51,081	291,861.92	10,378
	Bizneset	69,016.97	5,246	89,871.51	3,400
	Institucionet	21,461.06	504	21,696.09	311
	Shërbimet e kontraktuara	27,588.21	280		
	TOTAL:	469,860.05	57,111	403,429.52 €	14 089

MBETURINAT E GRUMBULUARA

Në vitin 2024 nga Komuna e Vitisë janë transportuar dhe deponuar gjithsej : 7112,65 ton, mbeturina të perziera komunale. Mesatarje e mbeturinave të gjeruara është 0,661 kg. koke banori.

1. Janar	569,88
2. Shkurt	434,77
3. Mars	456,17
4. Prill	528,52
5. Maj	514,87
6. Qershor	505,94
7. Korrik	857,62
8. Gusht	971,79
9. Shtator	695,62
10. Tetor	615,92
11. Nëntor	384,32
12. Dhjetor	577,23
Gjithsej:	7,112.65 ton

Përveç mbeturinave të perziera, Njesia punuese ka deponuar edhe një sasi të vogël të mbeturinave jo të konsumueshme. Mbetje me aftësi të skaduar Tarifa e deponisë është 50,00 euro.

III. LLOJET E MBETURINAVE

Grumbullohen disa lloje të mbeturinave: a) Mbeturinat e perziera komunale, b) Mbeturinat komerciale dhe c) Industriale.

Mbeturinat e amvisërisë janë ato mbeturina të cilat rrjedhin nga vendbanimet dhe objektet e ndryshme të banimit, duke përfshirë shtëpitë, vilat edhe institucionet (mbeturinat nga institucionet shkollore dhe parashkollore, kolegjet, drejtorit, objekte e fetare) etj.

Mbeturinat komerciale rrjedhin nga lokalet që shfrytëzohen plotësisht apo kryesisht për tregti, biznes, sport, rekreacion apo argëtim, me përjashtim të mbeturinave shtëpiake dhe industriale.

Mbeturinat industriale janë mbeturinat të krijuara nga bizneset apo proceset industriale, ndërsa përjashtohen mbeturinat nga minierat (gurorëve dhe mbeturinave bujqësore). Njesia punuese nuk ofron shërbime mbeturinave të kopshtit dhe të ngurta.

IV. SERVISI PËR RIPARIMIN E AUTOMJETEVE

Në kuadër të kompanisë Eco-Higjiena Sh. P. K Gjilan, punon punësoria për riparimin e automjeteve të kompanisë. Mirëmbahen te gjitha automjete nder to edhe 4 kamione të Njesise punuese te Vitisë..

Në këtë shërbim janë të punësuar punëtor të profileve të ndryshme siç janë: automekanik, auto elektrikist dhe saldues.

Për shkak të shtimit të vëllimit të punëve dhe ngarkesës së automjeteve, defektet janë të shpeshta. Në këtë punëtori rregullohen, defektet nga më të imtat e deri te riparimi i përgjithshëm. Përveç angazhimit të automekanikëve brenda objektit, këta punëtor herë pas here bëjnë intervenime edhe në terren, ndonëse për raste të tilla të angazhohet ekipi lëvizës

Riparimi bëhet sa më racional (shikohet mundësia e eliminimit të defekteve me pjesë të veta të automjetit, nëse nuk është mundësia të riparohet, sigurohen pjesë të gatshme dhe kompletohet.

Riparimi i automjeteve bëhet në përputhje me planin. Afati (orari) për lubrifikim, ngjyrosje dhe hartimi i raportit ditor është detyrë e përditshme.

Njesia është e pajisur me automjete të modeleve të ndryshme dhe firmave më të njohura siç janë: MAN.

V. KOSTO E STAFIT DHE MATERIALIT DIREKT-INDIREKT

1. Shpenzimet per Staf direkt	61380 .00	euro
2. Shpenzimet e stafit indirekt dhe administrativ.....	88567.48	euro
3. Shpenzimet per lënd djegese dhe materiale	70732, 37	euro
3. Shpenzime indirekte dhe administrative	13420,34	euro
4. Deponia	60176,20	euro
5. Shpemzime mbr.ne pune	228,79	euro
6. Investime	2652,52	euro

VI. DEPONIMI I MBETURINAVE

Mbeturinat të cilat grumbullohen gjatë procesit të punës, transportohen në Deponi Sanitare në Velekincë.

Shoferi i kamionit të ngarkuar, me rastin e shkarkimit përkatësisht deponimit të mbeturinave, fillimisht bën matjen në peshore, pastaj bëhet shkarkimi i tyre në punishte. Tarifa për shkarkim e mbeturinave është 8,31 euro, për 1 ton të shkarkuar të përziera dhe 50,00 euro për 1 ton, për mbeturina të rrezikshme.

VII.TARIFA E DEPONISE DHE NGRITJA E SHERBIMEVE

Tarifa e deponimit dhe ngritja sipas viteve, si vijon;

- Viti 2024 8,31 euro /ton
- Viti 2025 9,31 euro/ ton
- Viti 2026 10,31 euro /ton
- Viti 2027 11,31 euro Ton

Pershkak te rritjes së shpenzimeve të deponisë, Bordi i aksionarve ka miratuar nje rritje të shërbimeve si vijon:

- Viti 2024 6,20 Euro per kliente te amvisrisë
- Viti 2025 6,40 Euro per kliente te amvisrisë
- Viti 2026 6,60 Euro per kliente te amvisrisë
- Viti 2026 6,80 Euro per kliente te amvisrisë

VIII. RREGULLIMI I KONTEJNERËVE

Rregullimi i kontejnerëve paraqet një punë mjaft të rëndësishme nga se kompania disponon disa qindra kontejner të llojeve të ndryshme, të cilët janë të vendosur në qytete dhe fshatra.

Punëtorët e shërbimit, më së shpeshti kujdesen për ndërrimin e rrotave, rregullimin e kapakëve dhe ngjyrosjen e tyre.

Rregullimi i kontejnerëve për mbeturina, bëhet në objektin e kompanisë, njësi dhe në terren. Detyrë permanente e saldusit është riparimi me kohë i kontejnerëve dhe sipas planit të caktuar.

Ecohigjiena Sh.P.K. Gjilan - Njesia punuese Viti

